



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në subjektin “Bashkia Mat”**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**Auditim Financiar**

**Tiranë, Tetor 2024**

# CONTENTS

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
<b>I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit. ....</b>	<b>7</b>
<b>II. HYRJA.....</b>	<b>7</b>
<b>OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.....</b>	<b>8</b>
<b>1. Objektivat dhe qëllimi.....</b>	<b>8</b>
<b>2. Identifikimi i çështjes. ....</b>	<b>8</b>
<b>3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. ....</b>	<b>9</b>
<b>4. Përgjegjësitë e audituesve.....</b>	<b>9</b>
<b>5. Kriteret e vlerësimit.....</b>	<b>10</b>
<b>6. Standardet e auditimit ....</b>	<b>11</b>
<b>7. Metodatat e auditimit.....</b>	<b>11</b>
<b>8. Dokumentimi i auditimit. ....</b>	<b>12</b>
<b>1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Mat” .....</b>	<b>13</b>
<b>2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.....</b>	<b>14</b>
<b>2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. ....</b>	<b>14</b>
<b>2.2. Burimi i krijimit i të të ardhurave dhe mbledhje e tyre.....</b>	<b>29</b>
<b>2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi. ....</b>	<b>43</b>
<b>2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM. ....</b>	<b>58</b>
<b>IV. REKOMANDIME .....</b>	<b>61</b>
<b>E. MASA DISIPLINORE .....</b>	<b>71</b>
<b>F. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL.....</b>	<b>72</b>
<b>V. ANEKSET .....</b>	<b>72</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## **I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit dhe një informacion mbi buxhetin:**

Bashkia Mat, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Mat për periudhën e aktivitetit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

a. Për vitin 2023 nga Bashkia Mat janë shpenzuar gjithsej 671,188 mijë lekë nga të cilat: shpenzime për paga dhe kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 351,092 mijë lekë; për shpenzime operative në vlerën 123,430 mijë lekë; për shpenzimet korente të brendshme në vlerën 22,306 mijë lekë; për investime në vlerën 165,183 mijë lekë.

b. Për vitin 2023 Bashkia Mat nga mbledhja e taksave dhe tarifave vendore ka arkëtuar gjithsej vlerën 141,539 mijë lekë.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni merr rëndësi për arsye se administron, menaxhon dhe shpenzon, fonde të miratuar nga Këshilli Bashkiak Mat, me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit
- Burimi i krijimit të të ardhurave dhe mbledhja e tyre
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike të transferuara sipas VKM.

### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 10,873 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

**e. Nga shqyrtimi i evidencave,** rezultoi se institucioni për periudhën në auditimi paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 19 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime, nga ku masa organizative me 13 gjetje dhe 15 rekomandime, masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksa vendore 1 gjetje dhe 1 rekomandime në vlerën 40,671,223 lekë, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara për administrimin e fondeve publike 1 gjetje dhe 1 rekomandim në vlerën 30,242,573 lekë dhe masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore 4 gjetje dhe 4 rekomandime në vlerën 63,443,327 lekë.

**f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

*Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:*

-Bashkia Mat nuk ka pasur bashkëpunim me ASHK-Drejtoria Vendore për të marrë informacion mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Mat me vlerën e përlllogaritur. Deri në datën 31.12.2023 rakordimet me ASHK për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme nuk janë kryer, ndërsa me DRSHTRR për mjetet e regjistruara nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE;

- Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë, mbajtjen e akt-rakordimeve me ta dhe krijimin e një regjistri me të dhënat përkatëse nga agjentët;

-Nga auditimi i detyrimeve të palikuiduara të prapambetura për vitin 2023 në Bashkinë Mat, rezultoi se: Detyrimet e prapambetura paraqiten në 36 raste gjithsej për vlerën 29,073,330 lekë, sipas llojit detyrimeve në mënyre të grupuar, paraqiten:

- *Fatura pa likuiduara për mallra paraqiten 11 raste për vlerën 420,155 lekë.*

- *Fatura pa likuiduara për shërbime të ndryshme paraqiten 14 raste për vlerën 4,846,165 lekë.*

- *Fatura pa likuiduara për investime paraqiten 7 raste për vlerën 14,869,809 lekë.*

- *Vendime gjyqësore të pa likuiduara paraqiten 4 raste për vlerën 8,937,201 lekë,*

-Për vitin 2023 Bashkia Mat nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara. Bashkia Mat ka 3(tre) ndërmarrje varësie ,Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Futbollit Burrel dhe Tregu Mat.

Bashkia Mat ka hartuar pasqyrat individuale të aparatit të bashkisë të cilat i ka dorëzuar në degën e Thesarit Mat në datë 28.03.2023.

-Nga auditimi u konstatuar se detyrimet progresive për taksa dhe tarifatat vendore për abonentë privatë në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 45,441,358 lekë dhe përbëhe nga 410 abonentë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 13,308,015 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 8,537,880 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën 40,671,223 lekë për 353 abonentë.

-Nga auditimi u konstatua se detyrime progresive për taksat dhe tarifatat vendore për abonentë familjarë në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 55,759,890 lekë e përbërë nga 15,005 abonentë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 17,981,454 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 12,708,125 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën 50,486,470 lekë dhe përbëhet nga 11,822 abonentë.

**f. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

-Bashkia Mat dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat:

Për mbajtjen e dokumentacionit të munguar të pastrimit, për mbajtjen e akt rakordimeve të mjetit teknologjik dhe mjeteve të tjera të tjera të pastrimit duke krahasuar kilometrat e përshkuara sipas fletë-udhëtimeve me kilometrat sipas panelit të kontrollit të mjetit.

Të sigurohet mbikëqyrje dhe informacion mujor periodik, për mirëmbajtjen e varrezave.

Të disponojë çdo muaj dokumentacionin e punës për punonjësit e pastrimit duke pasqyruar volumin e punës së kryer mbështetur në normativat ligjore, për efekt të ngarkesës dhe shfrytëzimit të kohës së punës si dhe justifikimit të pagesës.

Të marrë masa për mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa e pastrimit, e cila destinohet për këtë shërbim.

-Sektori i infrastrukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Bashkiake të marrin masa për pajisjen me leje të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me afatin e përcaktuar në kuadrin ligjor për këtë lloj aktiviteti; të analizojë situatën e krijuar me 2 subjektet e bllokuara, me qëllim që në periudhat e ardhshme të arkëtohen detyrimet brenda afatit ligjor, arkëtimin e atyre të prapambetura për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja.

- Drejtoria Ekonomike, Bashkia Mat të hartojë pasqyrat financiare të konsoliduara për të pasqyruar informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t'i evidentojë në llogaritë 230 - 231 "Investime në proces" dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

-Kryetari i Bashkisë Mat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë . 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe 211 "Pyje, Plantacione" dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit ndaj 13 subjekteve në vlerën progresive të debisë 9,555,857 lekë dhe për një arkëtim paraprak të vlerës në llogari të Bashkisë Mat si garanci, për kontratat që do të lidhen në të ardhmen.

-Sektori i Taksa dhe Tarifa Vendore në bashkëpunim me drejtorinë e tjerë të Bashkisë Mat të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 40,671,223 lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

-Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e vlerës 22,942,342 lekë me kosto historike për aktivet, "Rregullim Lulishte Shkolla Shilli", "Shkolla 9-vjeçare "Mustafa.Gjestila", "Shkolla 9-vjeçare,"31-Korriku", "Sporti" dhe "Këndi i lojërave" së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 210 "Toka, Troje, Terrene" dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstrukione" në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

## I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

### A. OPINIONI I AUDITIMIT.

#### **Për auditimin e pasqyrave financiare:**

Ne kemi audituar, pasqyrat financiare individuale të Bashkisë Mat për vitin e fundit ushtrimor 01.01.2023 - 31.12.2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës financiare, pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Mat janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar, me rezervë", e shprehur kjo në bazën për opinionin.

#### **Baza për opinionin e modifikuar me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 10,873 mijë lekë.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

Gabimet materiale në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 dhjetor 2023, paraqiten si më poshtë: Nga Drejtoria e Financës janë kryer veprime mbi pasqyrimin e ngjarjeve ekonomike në kontabilitet në mënyrë jo të drejtë, kryesisht:

-Për vitin 2023 Bashkia Mat nuk ka hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara. Bashkia Mat ka 3(tre) ndërmarrje varësie ,Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Futbollit Burrel dhe Tregu Mat.

-Llogaria 101 "Teprica" është regjistruar në bilanc në datën 01.01.2023 në vlerën 3,257,823,616 lekë, shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 277,299,031 lekë (investimet, dhurimet dhe ndryshimi i gjendjes), pakësimet janë në vlerën 158,774,886 lekë (amortizim i vitit dhe nxjerrjet nga përdorimi).Në fund të vitit 2023 llogaria 101 "Teprica" është regjistruar për vlerën 3,941,033,038 lekë e cila është mbivlerësuar për vlerën 550,100,013 lekë.

-Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" është paraqitur e mbivlerësuar në vlerën 22,942,342 lekë e cila përbëhet nga 5 aktive të cilat duhet të regjistroheshin në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe Konstruksione".

-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është paraqitur e nënvlerësuar për vlerën 50,486,470 lekë detyrim i cili i përket abonentëve familjarë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 898/1 prot., datë 03.07.2024 "Auditim financiar në Bashkinë Mat", i miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 04.07.2024 – 02.08.2024, në subjektin

Bashkia Mat për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 - 31.12.2023, u krye “*Auditim Financiar*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K H, *Auditues i parë, Përgjegjës Grupi,*
2. B B, *Auditues i parë, anëtar;*
3. S J, *Audituese e parë, anëtar;*
4. K F, *Audituese e parë, anëtarë;*

## **OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA.**

### **1. Objektivat dhe qëllimi.**

Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që ti bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

Në këtë fazë të auditimit, hartohet raporti përfundimtar i auditimit, i cili përfshin dhënien e opinionit mbi bazën e vlerësimeve dhe të gjetjeve, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë së Bashkisë Mat.

### **2. Identifikimi i çështjes.**

Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bazë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Raporti i auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Mat, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kritereve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përsa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Mat.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.**

Kryetari i Bashkisë Mat (Administratori i Përgjithshëm), në cilësinë edhe të Nëpunësit Autorizues (NA) dhe Drejtori i Financës, në cilësisë e Nëpunësit Zbatues (NZ), janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare. Gjithashtu, në cilësinë edhe të NA si dhe NZ, janë përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bashkisë Mat, bazuar në ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, konkretisht neni 34/6, neni 65/1 dhe neni 91, pika 1.3.

NA i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në cilësinë e titullarit të kësaj njësie është përgjegjës për menaxhimin financiar aktivitetin e bashkisë.

Titullarët e njësive publike përgjigjen për vendosjen e përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të njësive publike, nëpërmjet krijimit të një sistemi të përshtatshëm dhe efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe përdorimit të fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, me vendim të veçantë, miraton të ardhurat dhe fondet buxhetore vjetore për njësitë e qeverisjes vendore dhe fondet speciale të tyre, me qëllim kryerjen e shpenzimeve për ushtrimin e funksioneve që kanë, si dhe huamarrjen, për financimin e projekteve të investimeve.<sup>1</sup>

Strukturat drejtuese të subjekteve të audituara kanë përgjegjësi që t'i dorëzojnë dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, si dhe informacionin e kërkuar, në kushtet, afatet dhe strukturën e vendosur prej grupit të auditimit të KLSH.

### **4. Përgjegjësitë e audituesve.**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Mat në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit.

Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.

Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kuptueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullsia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet.

Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Mat është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar gjykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese.

Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin

---

<sup>1</sup> Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 15

e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*”, paragrafi 44-51.

## **5. Kriteret e vlerësimit**

Auditimi është bazuar në ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “*Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 84/2022 “*Për buxhetin e vitit 2023*”, si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “*Për huamarrjen e qeverisjes vendore*”; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*” i ndryshuar; VKM 783 datë 22.11.2006 “*Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël*”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*”; UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” etj.; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*”, i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “*Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “*Për përgatitjen e buxhetit vendor*”; Udhëzimin plotësues të Ministrisë Financave nr. 2, datë 19.01.2023 “*Për zbatimin e buxhetit e vitit 2023*”; Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore*”. Udhëzimin nr. 8, datë 28.02.2022 “*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025*”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare*”; VKM nr. 248, date 10.4.1998 “*Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre*” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001; VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “*Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël*”; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial*”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “*Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme*” i ndryshuar; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “*Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial*”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “*Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore*”.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në RSH*”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “*Për sistemin e taksave lokale*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “*Për taksat kombëtare*”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre*”, me ndryshime; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “*Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006*” “*Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave*”; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar.

- Në fushën e administrimit e pronës publike: Ligji nr. 20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave të Bashkisë”.

## 6. Standardet e auditimit

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontroleve të brendshëm”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

## 7. Metodat e auditimit

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit<sup>2</sup>.* Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohem nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve)

---

<sup>2</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.
  - *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.
  - *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
  - *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër.
  - *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.
  - *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
  - *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
  - *Raporte dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.
- Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm të subjektit.

## **8. Dokumentimi i auditimit.**

Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “*Dokumentimi i Auditimit*”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit në terren, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u hartuan dhe u mbajtën 4 akt konstatime. Nga ana e Bashkisë Mat nuk janë paraqitur pretendime në lidhje me aktet e mbajtura duke vijuar me hartimin e Projekt Raportit të Auditimit dhe Informacionit përmbledhës. Në përfundim të auditimit në terren (Akt-Konstatimeve), të mbajtura mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projektraporti i Auditimi i cili u dërgua në subjekt me shkresën

nr. 898/2, datë 09.08.2024. Nga ana e Bashkisë Mat me shkresën nr. 4726/10, datë 27.08.2024 është dërguar konfirmimi i marrjes së projektraportit dhe observacionet përkatëse. Në përfundim nga audituesit u përgatit Raporti i Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Mat”

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

**Zona Gjeografike:** Bashkia Mat kufizohet në veri me bashkinë e Mirditës, në perëndim me bashkinë e Kurbinit, në jug-perëndim me bashkinë Krujë, në jug me bashkinë Klos dhe në lindje me Bashkinë Dibër. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Burrelit.

**Popullsia:** Sipas Censurit të vitit 2024 numëron një popullsi prej 17,405 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 38,615 banorë. Bashkia e re ka në një sipërfaqe prej 493.5 km<sup>2</sup>. Në bazë të të dhënave të censurit densiteti i popullsisë është 55.23 banorë/km<sup>2</sup> ndërsa në bazë të të dhënave të regjistrimit civil, densiteti është 35.26 banorë/km<sup>2</sup>.

**Të dhëna të tjera:** Bashkia e re shtrihet thuajse në të njëjtin territor me krahinën etnografike të Matit dhe ka terren kodrinor dhe malor. Ajo shtrihet në të dyja krahët e lumit Mat dhe pyjet zënë pjesën më të madhe të territorit të bashkisë së re. Shfrytëzimi i pyjeve për industrinë e drurit është aktualisht i kufizuar, pasi pyjet e vjetra janë dëmtuar rëndë nga prerjet pa kriter dhe një pjesë e madhe e sipërfaqes pyjore është aktualisht në fazë rigjenerimi.



Bashkia e re ka pjesë të saj parkun rajonal natyror Ulëz si dhe dy liqenet artificiale, Ulëza dhe Shkopeti, të ndërtuara për prodhimin e energjisë elektrike.

Relievi dhe klima mesdhetare mjaft e favorshme, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe nga dimri relativisht i butë në luginën e Matit krijon kushte mjaft të favorshme për zhvillimin e bujqësisë, frutikulturës dhe blegtorisë, përcakton si burime kryesore gjeneruese ekonomiko-financiare, bujqësinë dhe blegtorinë.

Qyteti i Burrelit u ndërtua i lidhur me industrinë e pasurimit të kromit, e cila është aktualisht në proces për riaktivizim. Gjithsesi kjo industri nuk është në gjendje të kthehet në burim të rëndësishëm punësimi për qytetin, që aktualisht ka rreth 11 mijë banorë.<sup>3</sup>

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.

<sup>3</sup> **Burimi:** <https://portavendore.al/bashkia-mat/pasaporta-e-bashkise-mat/>

Bashkia Mat, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Mat për periudhën e aktivitetit të vitit 2023, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe zbatimin e kuadrit rregullator ligjor të raportimit financiar.

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit**

### **2.1. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

**2.1.1.** Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor;

**2.1.2.** Çelja e fondeve buxhetore të vitit sipas miratimit me Vendim të Këshillit Bashkiak, ndryshimet gjatë vitit, analiza e tyre sipas artikujve, arsyet e këtyre ndryshimeve.

**2.1.3.** Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me akt rakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.

**2.1.4.** Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, çelja e fondeve dhe realizimi i tyre.

**2.1.5.** Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZHR dhe Ministrive të linjës etj.).

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- 1.** Dokumentacioni i hartimit të PBA 2023-2025 auditimi, miratimi i tyre dhe korrespondenca me Ministrinë e Linjës;
- 2.** Dokumentacioni i programimit të buxhetit vjetor për periudhën objekt auditimi, i miratuar me VKB, fondet e transfertës së pakushtëzuar, të kushtëzuar dhe specifike nga MFE, si dhe korrespondenca zyrtare për ndryshimet në buxhet gjatë kësaj periudhe buxhetore;
- 3.** Akt-rakordimet periodike me Degën e Thesarit Mat për shpenzimet dhe të ardhurat;
- 4.** Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative;
- 5.** Shkresat përcjellëse në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për detyrimet e papaguara të institucionit ndaj të tretëve, si fatura të palikujuara dhe vendimeve gjyqësore;
- 6.** Dokumentacioni mbi transferimin e fondeve buxhetore gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe saktësia e pasqyrimin të ndryshimeve në shtesa dhe pakësim me planin përfundimtar.
- 7.** Dokumentet e hartuara në mënyrë periodike për monitorimin e zbatimit të buxhetit për periudhën objekt auditimi;
- 8.** Dokumente të tjera mbështetëse (baza të ndryshme të dhënash në programin “Excel”, si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditarët, shpenzimet, të ardhurat etj).
- 9.** Dokumentacioni i mbajtur mbi debitorët dhe kreditorët.

#### **2.1.1. Programimi PBA-së dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023:**

Bashkia Mat për vitin 2023 ka hartuar dhe miratuar buxhetin, në zbatim të kërkesave:

- te ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

- te ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”,
- te ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin sistemit buxhetor RSH” ndryshuar,
- te ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, - të ligjit nr. 84/2022, date 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”,
- te udhëzimit plotësues MF nr. 1 date 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2023”.
- te UMF 8 datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afat mesëm 2023-2025”,
- te UMF 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde te zbatimit te buxhetit”,
- te UMF 2 datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2023”,
- të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”,

Për vitin 2023 buxheti i Bashkisë Mat është miratuar me VKB nr. 134, datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023”, me VKB nr. 04 datë 27.03.2023 “Për miratimin e fondeve te trashëguara nga viti 2022”, me VKB nr. 114 datë 25.11.2022 “Për miratimin tavaneve përfundimtare te programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025 te Bashkisë Mat”.

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2023 me VKB nr. 134 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023” është bërë brenda afateve ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 32 të ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Programimi buxhetor afatmesëm i Bashkisë Mat parashikon një mbulim sa me të plotë të territorit me shërbime publike cilësore, me qëllim përmirësimin e jetës së komunitetit, përmirësimin dhe modernizimit e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale, përmirësimin e pastrimit të qytetit, rritjes së sipërfaqeve të gjelbëruara, zhvillimin e mirëmbajtjen e tregjeve, zhvillimin e turizmit, mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të biznesit, mbrojtjen e tokave bujqësore, mbrojtjen e mjedisit, mbulimin e territorit me shërbime sociale, zhvillimin e aktiviteteve kulturore e sportive, menaxhimin e situatave natyrore, etj.

Programimi i PBA 2023-2025 parashikon burimet e financimit që janë:

- Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore, nga tarifat vendore, nga të ardhurat të tjera dhe të ardhura që trashëgohen.

- Nga burimet qëndrore, ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta specifike për funksionet e reja, qe i janë transferuar bashkisë dhe transferta e kushtëzuar.

Me urdhër të Titullarit të Bashkisë nr. 684 datë 31.12.2021 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025,

Tavanet buxhetore janë miratuar me VKB nr.37, datë 29.03.2022 “Për miratimin e tavaneve dhe pasqyrave të programimit buxhetor afatmesëm vendor 2023-2025”, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37. Disponohet ky VKB “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Mat për vitet 2023-2025”, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Këshilli Bashkiak Mat ka marrë Vendim për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 33, sipas VKB nr. 127 datë 17.12.2021.

Disponohet Plani i Masave dhe Veprimet, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës, bazuar ne Udhëzimin e brendshëm të titullarit të njësisë vendore nr. 256 datë 08.04.2022

Ka mbledhje të dokumentuara të GMS për diskutimin rreth planifikimit, monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar e kontrollit.

Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA e viteve të mëparshme dhe mbi një analizë të mirëfilltë.

Bashkia Mat është mbështetur në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, konkretisht sipas neneve, 33, 34, 35, 36, 37, dhe në Udhëzimet nr. 8 datë 28.02.2022 dhe nr. 23, datë 08.07.2022 “Për procedurat standarde përgatitjes PBA njësie vendore”.

Disponohet dokumentacioni për dëgjesa publike me komunitetin dhe grupet e interesit, sipas protokollit të mbajtur me datë 10.02.2022, datë 13.04.2022 dhe 28.08.2022.

Gjithashtu është bërë analiza dhe monitorimi i buxhetit çdo 4-mujor gjatë vitit 2023.

Raportet e monitorimit janë diskutuar dhe miratuar në Këshillin Bashkiak, dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave brenda afateve ligjore, sipas kërkesave të shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe shtojcës 5 "Treguesit monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të UMFE 22 datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësvive vetëqeverisjes vendore".

Raportet e monitorimit për çdo 4-mujor 2023 janë të plota me të gjitha anekset, sipas kërkesave të ligjit 68/2017 "Për Financat Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit 22 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde monitorimit buxhetit njësvive vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

Dokumenti i PBA 2023-2025 nga Bashkia Mat është dërguar, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Drejtorisë të Financave Vendore, sipas shkresave nr.2105, datë 30.05.2023, nr. 5182 datë 28.09.2023 dhe nr. 857 datë 28.02.2024 "Dërgim raporti monitorimi për 4-mujorin I, II dhe III 2023".

- Realizimi i të ardhurave për 12 mujorin e vitit 2023 paraqitet 91 % krahasuar me planin (fakt 141,539,668 lekë dhe 155,937,749 lekë ,plani).

Peshën me të madhe e zënë të ardhurat jo tatimore, të ndara sipas llojit të të ardhurave, përkatësisht: të ardhura tatimore 88% (fakt 43,066.223lekë dhe plani 48,856,000 lekë) dhe të ardhura jo tatimore 93% ( fakt 97,229,445 lekë dhe plani 104,306,749 lekë) si dhe të ardhura nga sponsorizimet 45 % (fakt 1,244,000 lekë dhe plani 2,775,000lekë).

Dinamika e të ardhurave ndër vite ka tendence në rritje, konkretisht: viti 2019 paraqet 75,077 mijë lekë, viti 2020 paraqet 96,493 mijë lekë, viti 2021 paraqet 114,007 mijë lekë, viti 2022 paraqet 118,763 mijë lekë dhe viti 2023 paraqet 141,539 mijë lekë,

- Realizimi i buxhetit për 12 mujorin e vitit 2023 paraqitet ne masën 91 % krahasuar me planin (plan 1,796,339 mijë lekë dhe fakt 1,631,893 mijë lekë), sipas artikujve paraqitet:

Zëri "paga" (600) plan=309,699 mijë lekë, fakt=308,703 mijë lekë ose 17%,

Zëri "sig.shoq.shënd."(601) plan=51,788 mijë lekë, fakt=51,400 mijë lekë ose 3%,

Zëri "mallra e shërbime" (602) plan=128,591 mijë lekë, fakt=97,510 mijë lekë ose 7%,

Zëri "Transferta korent brend" (604) plan=27,445 mijë lekë, fakt=24,658 mijë lekë ose 2%,

Zëri "Transfertë për buxhetin familjar dhe individ" (606) plan=384,540 mijë lekë, fakt=365,905 mijë lekë ose 21 %,

Zëri "investime" (231) plan= 894,276 mijë lekë, fakti = 783,719 mijë lekë, i cili zë peshën kryesore të shpenzimeve të buxhetit ose 50 % të buxhetit të vitit 2023.

**Tabela 1:** Programimi i shpenzimeve për vitin 2023-2025 dhe i detajuar sipas programeve paraqitet, sipas PBA.

Nr.	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	%	000/lekë	%	000/lekë	%
1	Planifikimi Menaxhimi dhe Administrimi	154,791	18	139,264	16	152,976	17
2	Shërbimet e Policisë Vendore	10,710	1	10,350	1	11,150	1.2
3	Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile	20,502	2.4	20,502	2	21,002	2.3
4	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik	2,585	0.3	4,900	1	1,750	0.2
5	Shërb. Bujq., Insp., Sig. Ushq Mbr Kons.	18,000	2.1	18,000	2	18,000	2
6	Menaxhimi Infrastruk Ujitjes- Kullimit	12,563	1.5	12,563	1	12,563	1.4
7	Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave	9,467	1.1	9,467	1	9,500	1.1
8	Rrjeti Rrugor Rural	46,970	5.5	63,654	7	75,632	8.4
9	Transporti Publik	0	0	0	0	0	
10	Menaxhimi i Mbetjeve	19,750	2.3	20,816	2	22,426	2.5
11	Planifikimi Urban Vendor	0	0	0	0	4,000	0.4
12	Shërbimet Publike Vendore	46,500	5.4	46,500	5	46,500	5.2
13	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	0	0	0	0	0	0
14	Shërbimet e Kujdesit Parësor	0	0	0	0	0	0
15	Sport dhe Argëtim	11,500	1.3	12,000	1	22,000	2.4
16	Trashëg. Kultur, Eventet Artistike Kult.	15,614	1.8	13,130	1	13,240	1.5
17	Arsimi Bazë përfshirë Parashkollorin	93,822	1.1	98,632	11	88,186	9.8

18	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	25,613	3	33,543	4	21,500	2.4
19	Përkujdesi Social	361,910	42.3	367,930	42	374,940	4.1
20	Strehimi Social	0	0	0	0	0	0
21	Fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës	5,000	6	6,000	1	6,000	0.7
	<b>Totali</b>	<b>855,298</b>		<b>877,251</b>		<b>901,366</b>	

**Burimi:** Punoi Grupi i Auditimit

**Tabela 2:** Ndarje e shpenzimeve sipas natyrës për vitet 2023-2025, paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Shpenzimet sipas programeve	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2025	
		000/lekë	%j/total	000/lekë	% /total	000/lekë	% /tot
1	Paga (600)	281,950	33	282,971	32.3	284,984	31.6
2	Sigurime (601)	47,086	5.5	47,256	5.4	47,592	5.3
3	Shpenzime operative (602)	95,307	11.1	95,745	10.9	103,107	11.4
	Shpenzime (604)	10,000	1.2	10,000	1.1	20,000	2.2
	Shpenzime (606)	356,500	41.7	363,500	41.4	371,000	41.2
	Shpenzime (609)	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime për investime )230-231)	64,454	7.5	77,780	8.9	74,682	8.3
	<b>Shuma</b>	<b>855,298</b>		<b>877,251</b>		<b>901,366</b>	

**Burimi:** Punoi Grupi i Auditimit

**Tabela 3:**Sipas PBA 2023-2025 tendenca e të ardhurave paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Të ardhurat në 000/lekë (PBA) 2023-2025.

A	Të ardhurat	2023	2024	2025
1	Nga taksat	49,653	50,646	51,659
2	Jo tatimore	78,100	79,662	81,256
I	Totali	127,753	130,308	132,915
1	Transferta e pakushtëzuar	207,856	221,193	235,556
2	Transferte specifike	519,689	525,750	532,895
II	Shuma e transfertave	727,545	746,943	768,451
III	Transferta te pritshme (FZHR e tjera)	0	0	0
	<b>Totali i burimeve të veta (I +II+III)</b>	<b>855,298</b>	<b>877,251</b>	<b>901,366</b>

**Tabela 4:**Të dhënat mbi buxhetin fillestar

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	<b>Të ardhurat</b>	<b>671,188</b>	
2	Të ardhura të veta të trashëguara sipas rakordimeve me thesarin	48,450	
3	Të ardhura e vitit ushtrimorë	178,744	
4	Transferta e pakushtëzuar	273,846	
5	Transferta specifike	170,148	
6	<b>Shpenzimet</b>		<b>556,388</b>
7	Paga (600)		300,467
8	Sigurime (601)		50,179
9	Shpenzime (602)		99,478
10	Shpenzime (604-606)		20,306
11	Investimet (230 +231)		83,335
	<b>Totali i buxhetit</b>	<b>634,502</b>	<b>556,388</b>

**Burimi:**Punoi Grupi i Auditimit

**2.1.2. Celja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të celura.**

- Për vitin 2023 buxheti fillestar i Bashkisë Mat për shumën 520,197 mijë lekë është miratuar me VKB nr. 134 datë 22.12.2022 "Për miratimin e buxhetit 2023".

- Buxheti i trashëguar nga viti i mëparshëm 2022 për vlerën 48,451 mijë lekë sipas VKB nr. 04 datë 27.03.2023 “Për miratimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022”,  
-Buxheti fillestar bashkë me ndryshimet gjatë vitit 2023 paraqitet për vlerën 671,188 mijë lekë (pa përfshirë transfertat e deleguara).

**Ndryshimet gjate vitit 2023 paraqiten sipas VKB :**

VKB nr. 11, datë 20.06.2023, për shtesa të rritjes së pagave në vlerën 5,549,918 lekë llogaria 600 dhe 601, për transferat sektoriale.

VKB nr. 22, datë 28.07.2023, për rritjen e pagave në vlerën 18,821,376 lekë llogaria 600 dhe 601, për pagat nga transfertat e pakushtëzuar.

Rritja e pagave bazohet në VKM 240, 241 dhe 242 datë 20.04.2023 “Për rritjen e pagave.”

VKB nr. 16/1, datë 27.02.2023, ku është pakësuar fondi rezervë 609 për vlerën 250,000 lekë dhe është shtuar ndihma financiare 606 për këtë vlerë, bazuar në kërkesat e disa qytetareve me probleme të rënda ekonomike-shëndetësore, të cilat i janë nënshtruar procedurave ligjore.

VKB nr. 26 datë 25.04.2023, ku është pakësuar fondi rezerve 609 për vlerën 140,000 lekë dhe është shtuar ndihma financiare 606 për këtë vlerë, bazuar në kërkesat e disa qytetareve me probleme të rënda ekonomike-shëndetësore, të cilat i janë nënshtruar procedurave ligjore.

VKB nr. 16, datë 13.07.2023, pakësuar dhe shtuar vlera prej 11,682,009 lekë, konkretisht:

**Pakësuar:**

Është pakësuar llog: 231 vlera 6,000,000 lekë “Për Rehabilitimin e monumenteve historike – kulturore në hapësirat urbane në qytetin Burrel”.

Pakësuar 231 për blerje kondicioner për QKF në vlerën 1,000,000 lekë.

Pakësuar zëri paga llog:600 në vlerën 3,682,009 lekë.

Pakësuar zëri fondi rezerve llog:609 në vlerën 1,000,000 lekë.

**Shtesa:**

Shtesa për vlerën 11,682,009 lekë, për bashkëfinancime për ndërtim shkollash, rikonstrukcion ish-hoteli i uzinës Ferrokromit Burrel dhe mbikëqyrje e kolaudime për këto objekte.

Arsyeja e shtesës është planifikimi i projektit gjate vitit dhe jo në fillim, pasi ky objekt është blerë nga Bashkia dhe do të adoptohet për banesa sociale me interes publik për strehimin e qytetarëve në nevojë.

Po kështu janë ndërtuar dhe rikonstruktuar 2 shkolla konkretisht: Shkolla 9-vjeçare “Rexhep Kertuka” ndërtim dhe shkolla mesme “Pjeter Budi” rikonstrukcion.

VKB nr. 17 datë 13.07.2023, për pakësimin e llogarisë 606 emergjenca civile për vlerën 1,664,986 lekë, e cila i është shtuar llogarisë 231 për supervizim dhe kolaudim “Ura Pasarele” në fshatin Rreth- Bazë në vlerën 464,986 lekë si dhe blerje naftë për emergjenca në vlerën 1,200,000 lekë.

VKB nr. 30 datë 08.09.2023, për miratimin e një shtese për llogarinë 231, ardhur nga AZHBR, për restaurimin e godinës për vënie në funksion të tregut fruta-perime në vlerën 26,941,749 lekë.

VKB nr. 31 datë 08.09.2023, për miratimin e një ndryshimi fondesh, ku është pakësuar fondi i kontigjencës llogaria 609 në vlerën 2,000,000 lekë dhe kjo vlerë i është shtuar për sportin (KF) llogaria 604.

VKB nr. 33 datë 29.09.2023, për ndryshim fondesh, ku është pakësuar shpenzimet operative 602 në vlerën 363,319 lekë dhe kjo vlerë i është shtuar llogarisë 231 për programin ACTE Mat.

VKB nr. 34 datë 29.09.2023, për ndryshim fondesh, ku janë pakësuar fondet e Bashkisë Mat dhe kanë kaluar tek Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkiake 600 dhe 601 njësi shpenzuese me bilanc më vete në vlerën 6,287,470 lekë.

VKB nr. 47 datë 30.11.2023, konfirmuar nga Prefektura Dibër sipas shkresës nr. 1186/1 datë 06.12.2023, mbi bazën edhe të relacionit të Drejtorisë Ekonomike datë 28.11.2023, për përdorimin e fondit të kontigjencës llog: 609, ku është pakësuar në vlerën 1,350,000 lekë dhe është bërë shtesë në llogarinë 600 dhe 601 në këtë vlerë, e cili përbëhet: nga paga të arsimit 9-vjeçar, mesëm, çerdhe si dhe 2(dy) ndihma vështirësie financiare e shëndetësore.

VKB nr. 60 datë 22.12.2023, për miratimin e një shtese në buxhet në vlerën 27,177,533 lekë për shlyerjen e disa detyrimeve të prapambetura si: transferata për sportin, shërbimi i pastrimit, vendime gjyqësore dhe bashkëfinancim me FZHSB për Ujësjellësin German.

VKB nr. 83 datë 27.09.2022, për një shtesë në buxhet në vlerën 23,264,690 lekë nga fondet e BE fonde ICT e Mat për projektin “*Inovacionin dhe kultura për te fuqizuar Matin*”, depozituar në degën e thesarit Mat për llogari të vitit 2023, sipas shkresës nr 153 datë 12.01.2023.

Vendimi Këshillit Qarkut Dibër nr. 5 datë 13.04.2023, ku është akorduar vlera 400,000 lekë për aktivitete artistike (*Festivali Gjirokastrës*) llogaria 602.

Vendimi Këshillit Qarkut Dibër nr. 22 datë 20.10.2023, ku është akorduar vlera 200,000 lekë për aktivitete artistike (*Kënga epike lirike edicioni i 8*) llogaria 602.

Për vitin 2023 buxheti përfundimtar i bashkisë Mat paraqitet për vlerën 671,188 mijë leke (***pa përfshirë transferatat e deleguara***), sipas pasqyrës nr. 1 te buxhetit 2023, i ndare:

- buxheti fillestar 520,197 mijë lekë,
- buxheti trashëguar 48,451 mijë lekë,
- buxheti shtesë gjatë vitit 102,540 mijë lekë.

Buxheti total 2023 për 671,188 mijë lekë.

### **Analiza e shpenzimeve sipas artikujve 2023.**

#### **a. Shpenzimet për paga.**

Shpenzimet për paga janë planifikuar për vlerën 307,346 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 306,182 mijë lekë. Bashkia Mat për vitin 2023 ka gjithsej 508 punonjës, nga këto:

- 59 punonjës me status nëpunës civil, ku marrëdhëniet e punës rregullohen sipas ligjit nr. 152-2013, “*Për Nëpunësin Civil*”.
- 436 punonjës me kontrate pune, marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës në RSH*”.
- 13 punonjës funksionarë politik.

Për vitin 2023 Bashkia Mat bashkë me 8 njësitë administrative funksionon me një strukturë dhe organike prej mesatarisht 502 punonjës fakti nga 519 punonjës plani fillestar dhe 521 punonjës pas shtesave të strukturës gjatë vitit 2023, (126 administrata këtu nuk përfshihen punonjësit administrativ dhe 214 funksione të deleguara),

#### **Pagat dhe ndalesat tatimit mbi pagat personale e sigurime shoqërore e shëndetsore.**

Bashkia Mat ka planifikuar dhe miratuar pagat për vitin 2023 për çdo vend pune sipas strukturave organizative, mbështetur në ligjin nr. 10405 datë 24.03.2011, “*Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve*” ndryshuar, ne VKM nr. 165 datë 02.03.2016, “*Për Pagat e Vetëqeverisjes Vendore*”, ne VKM nr. 187 datë 08.03.2017, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve pagave të nëpunësve Civilë*” ndryshuar, bazuar në klasat, kategoritë, pagën e grupit dhe shtesën për vjetërsi e pozicion. Pagat dhe shtesat mbi paga si vjetërsia e punës etj janë përllogaritur drejtë, sipas tabelës pagave, në përputhje me VKM e sipërcituara. Për ndryshimet ne vitin 2023 niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 29 datë 26.07.2023 në zbatim të VKM nr. 328 datë 31.05.2023, “*Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 165 datë 02.03.2016 “Për grupimin e njësisve të qeverisjes vendore për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionareve të zgjedhur dhe të emëruar të nëpunësve civile e të punonjësve administrative të njësisve të qeverisjes vendore*”.

Detyrimet për tatimin mbi të ardhurat personale dhe sigurime shoqërore e shëndetsore janë llogaritur dhe ndaluar sistematikisht për çdo muaj. Pagesat për punonjësit bëheshin për çdo muaj mbi bazën e kohëshënuesit që lëshohej nga përgjegjësi i administratës, e cila konfirmohej nga kryetari dhe dërgohej financës për veprime.

Pagesat për shpërblimin e 21 anëtarëve të Këshillit Bashkisë janë kryer në masën 10 për qind të pagës së kryetarit të Bashkisë. Numri 21 i Këshilltareve Bashkiak është bazuar në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, neni 24 “*Numri i*

*anëtareve të Këshillit Bashkiak” ndryshuar me ligjin nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.*

#### **b. Shpenzimet për ndihmën ekonomike.**

Në Bashkinë Mat për vitin 2023 përfitojnë 1,607 familje ndihmë ekonomike.

Në Bashkinë Mat për vitin 2023 përfitojnë 1,280 persona ndihmë ekonomike (PAK).

#### **c. Shpenzimet operative.**

Artikulli 602 “*Mallra dhe shërbime të tjera*” është planifikuar në vlerën 125,617 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 101,533 mijë lekë ose në masën 81 %, këto shpenzime janë financuar nga të ardhurat si mëposhtë:

Të ardhurat e veta në vlerën 26,856 mijë lekë,

Të ardhura nga grandit në vlerën 49,342 mijë lekë,

Transferta e kushtëzuar në vlerën 2,054 mijë lekë,

Transferta e pakushtëzuar në vlerën 23,281 mijë lekë,

Në **aneksin nr. 2/1/1** bashkëlidhurr raportin përfundimtar të auditimit paraqiten shpenzimet operative llogaria (602) sipas situacionit të shpenzimeve.

Peshë të rëndësishme në shpenzimet operative për vitin 2023 të Bashkisë Mat zënë këto zëra analitik, konkretisht:

- Blerje materiale të ndryshme ndërtimi për vlerën 11,308,168 lekë, përdorur për meremetimin e objekteve shkollore e tjera si dhe për infrastrukturën rrugore rurale etj.

- Likuidim shpenzime pastrimit dhe gjelbërimi për vlerën 9,636,319 lekë, shumë e cila i përket faturave të prapambetura para vitit 2023, ku shërbimi i pastrimit qytetit mbulohej me sipërmarrje private.

- Likuidim energji elektrike për vlerën 9,075,426 lekë,

- Blerje naftë dhe benzine pa plumb për vlerën 17,348,351 lekë,

- Likuidim vendime gjyqësorë për vlerën 7,780,496 lekë,

#### **Shpenzimet e pastrimit.**

Pastrimi i qytetit nga mbetjet urbane kryhet dhe mbulohet nga vetë Bashkia Mat. Shpenzimet e pastrimit për vitin 2023 paraqiten në vlerën 29,029,000 lekë, shumë që përfaqëson shlyerjen e detyrimeve të viteve të mëparshme ndaj firmës sipërmarrëse të pastrimit.

Tarifa e pastrimit është realizuar për vlerën 45,668,349 leke, ku përfshihen dhe arkëtimi i tarifës së pastrimit nga vitet e mëparshme, vlera e arkëtuar vetëm për vitin 2023 nuk mund të evidentohet e ndarë.

Mbikëqyrja e pastrimit mbulohet nga Drejtoria e Shërbimeve të Bashkisë, e cila disponon dokumentacion për pastrimin e qytetit Burrel nga mbetjet urbane, përkatësisht:

Grafiku i punimeve mujore është mbajtur për çdo muaj të vitit 2023, për zërat e punës (pastrim, fshirje, grumbullim, sistemim, transport për mbetjet urbane).

Fletëudhëtimet mbahen për çdo muaj ku pasqyrohen kilometrat dhe sasia e naftës për çdo ditë të mjetit pastrimit dhe mjeteve të tjera të rënda fadroma e kamionçina në orë pune.

U konstatua se përgjegjësja e sektorit të menaxhimit të mbetjeve në fund të çdo muaji mbante një aktrakordim lidhur me naftën e furnizuar me harxhimin e saj dhe gjendja në fund të muajit.

Akt-rakordimet ishin të parregullta në formë dhe në përmbajtje, pasi janë mjaftuar vetëm me sasinë e karburantit të furnizuar dhe të harxhuar si dhe gjendja në fund duke u firmosur vetëm nga përgjegjësja.

Akt-rakordimet nuk janë plotësuar me gjithë të dhënat e kërkuara, kështu ky dokument nuk ka çelje në fillim dhe në fund, nuk ka datë dhe numër si dhe nuk ka nënshkrime nga pala tjetër e drejtuesve të mjeteve dhe magazinieri.

Gjithashtu akt-rakordimi nuk pasqyron shumë e kilometrave mujore të përshkuara nga çdo mjet sipas normatives së miratuar, për efekt të justifikimit të karburantit të harxhuar.

Njëkohësisht nuk ka rakordim midis kilometrave sipas fletëudhëtimeve dhe kilometrave sipas panelit të kontrollit ose akt-kolauditimit (kontrolli teknik) të automjeteve, për efekt të saktësisë së kilometrave të pasqyruara në fletëudhëtimet përkatëse.

Veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik , Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve, pika 36, ku citohet:

*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit datën dhe vendin e kryerjes,objektin , treguesit sasiorë dhe ato të vlerës , personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet duhet të jenë pa korrigjime, të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa numërimin e dyfishtësh dhe atë të mashtrimeve.*

Mbikëqyrja e pastrimit nuk ka qenë periodike dhe e dokumentuar, pasi: mungojnë procesverbalet ditore, informacionet mujore për cilësinë shërbimeve, për punën e kryer dhe të pakryer për çdo zë pune, sipas zonave dhe rrugëve. Nuk disponohet dokumente për ditët me shi, në zërat e fshirjes së rrugëve, shesheve dhe larjen e tyre. Nuk ka dokumente lidhur me largimin e mbetjeve urbane sipas tonazhit tyre për çdo rrugë. Nuk disponohet dokumente për të pasqyruar dhe zbritur sipërfaqet e zëna nga rikonstruktionet e rrugëve, shesheve, trotuareve të qytetit të kryera gjatë vitit 2023, objekt investimesh. Nuk disponohet asnjë informacion lidhur me mirëmbajtjen e varrezave.

Mungon dokumentimi i punës së kryer për punëtorët e normuar të pastrimit lidhur me volumin e punës sipas normativave ligjore, për efekt të ngarkesës dhe shfrytëzimit të kohës së punës, por është mjaftuar vetëm me listë prezencën e tyre.

Veprime në kundërshtim me nenin 61 të rregullores së brendshme të Bashkisë Mat miratuar në Këshillin Bashkiak në vitin 2016 me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”,

### **Shpenzimet për energjinë elektrike.**

Bashkia Mat ka likuiduar për vitin 2023 faturat e OSHEE, por padrejtësisht në këto fatura është shtuar si zë shpenzimi edhe taksa e aparateve (televizionit) prej 100 lekë/rast, (tregu lire, linjat e ndriçimit rrugor në 8 njësitë vendore dhe në shkollat në njësite administrative e tjerë), në kushtet kur nuk ka aparate televizive, çka ka shkaktuar shpenzime tepërta, pavarësisht vlerave të vogla, Bashkia nuk ka kundërshtuar këtë problem, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 9, pika 4, neni 12 pika 3.

### **Shpenzimet për automjetet.**

Bashkia Mat ka hartuar normativat e karburantit për 100/km të përshkuara dhe për orë pune (për makineri të rënda) për automjetet e saj.

Bashkia Mat për vitin 2023 disponon 38 automjete gjithsej, nga këto: 35 automjete janë në gjendje pune dhe 3 mjete nuk janë në gjendje pune.

Automjetet e Bashkisë Mat për vitin 2023, sipas llojit, markës, vlerës dhe normave të karburantit për 100 km, paraqiten në mënyrë analitike në **aneksin nr. 2/1/2** bashkëlidhurbashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Nga verifikimi i dokumentacionit për karburantin e harxhuar nga automjetet për vitin 2023, u konstatua se janë mbajtur fletëudhëtimet me nënshkrimet përkatëse, disponohen autorizimet e eprorit për furnizim me karburant, akt rakordimet për sasinë e naftës të furnizuar dhe të harxhuar dhe diferencat e mbetura, por u vërejtën edhe disa mangësi në dokumentacionin e tyre, konkretisht: -Fletë-udhëtimet paraqesin disa parregullsi në plotësimin e tyre, pasi kanë korrigjime, plotësohen lëvizje të brendshme pa kriter, plotësohen kilometra pa u bazuar në kilometrazhin e miratuar në DPSHTRR për distancat midis rretheve dhe në vendimin e KQ për distancat e rrugëve brendshme të rrethit Mat.

-Nuk janë rakorduar kilometrat e përshkuara sipas fletë-udhëtimeve me kilometra sipas panelit të kontrollit ose aktkolaudimit (kontrollit teknik) të çdo makine, për efekt të saktësisë së kilometrave të pasqyruara në fletë-udhëtimet përkatëse për justifikimin e karburantit.

-Mungojnë normat mujore të miratuara në KB për çdo makinë, për vitin 2023.

-Mungon analiza ekonomiko-financiare për efektivitetin dhe rentabilitetin e çdo automjeti, pasi Bashkia disponon një numër të lartë automjesh prej 38 makina në raport me nevojën, ngarkesën dhe shfrytëzimin e tyre, përkatësisht:

- 13 Autovetura dhe Foristrada si dhe Furgona,
- 25 Mjete të Renda si: Mjete teknologjike, Fadroma, Ekskavator, Rul, Kamionë, Borëpastruese, Mjete Zjarrfikëse, Autobus etj.

-Shpenzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve për vitin 2023 janë në vlerën 22,518,767 lekë, ose në masën 22 % ndaj shpenzimeve operative, konkretisht:

- \* Blerje naftë dhe benzine pa plumb për vlerën 17,348,351 lekë,
- \* Blerje pjese këmbimi dhe mirëmbajtje e riparime për vlerën 4,483,500 lekë,
- \* Likuidim për kolaudime për vlerën 135,898 lekë,
- \* Likuidim siguracione makinash për vlerën 551,018 lekë,

Vlerësimi i automjeteve nëse janë rentabël ose jo është domosdoshmëri, për efekt të reduktimit të numrit të lartë të tyre, për pasoje edhe uljes së shpenzimeve të automjeteve. Për mjetet që nuk janë në gjendje pune 3(tre) automjete, përkatësisht: *Ëolzvagen Passat, Mjet Ngjeshës Rul dhe Kamion Mercedes Benz*, këto mjete të cilat nuk janë në gjendje punë nuk vërtetohen me dokumentacion justifikues si dhe mungojnë procesverbalet për vlerësimin e gjendjes së tyre *tekniko-gjenerike-motorrike* nga specialistë të fushës (ing. mekanik), mungon relacioni dhe analiza në KB, për fillimin e procedurave ligjore për asgjësimin ose kalimin në ankand të tyre.

Veprime në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin aktiveve njësitë publik*”, me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “*Për kontabilitetin*” ndryshuar me ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”.

### **2.1.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të celura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me aktrakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve.**

Për vlerësimin e programimit dhe zbatimit të buxhetit vjetor për vitin 2023 të Bashkisë Mat janë analizuar fillimisht planifikimet buxhetore afatmesme për përballimin e nevojave për vitet në vijim në bazë të eksperiencës së viteve të kaluara dhe nevojave reale si pasoje e ndryshimeve në vitin e pritshëm buxhetor.

Ky planifikim është detajuar sipas zërave të artikujve buxhetore në nivel klasifikimi 7-shifror sipas klasifikimit buxhetor të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Në vijim janë analizuar të gjitha shkresat e miratimit të buxhetit vjetor së bashku me ndryshimet gjatë vitit në funksion të përcaktimit të planit përfundimtar dhe në kuadër të ndryshimeve të autorizuara nga nivelet përkatëse autorizuese.

Plani përfundimtar i buxhetit sipas shkresave përkatëse është krahasuar me situacionin progresiv të thesarit për të përcaktuar nivelin e planit përfundimtar dhe realizimin e tij.

Për artikujt buxhetorë të cilët kanë pasur nivel më të lartë mos realizimi është bërë dhe një analizë më e detajuar në të cilën është identifikuar dhe përcaktuar devijimi në llogaritë përkatëse, qoftë ky material nga ana cilësore apo nga ana sasiore.

Auditimi është drejtuar edhe në përcaktimin e saktësisë së klasifikimit të zërave buxhetorë sipas realizimit dhe kryerja e testeve u orientua në krahasimin e situacionit faktik të realizimit të buxhetit të konfirmuar nga struktura përgjegjëse për thesarit dhe databazës së publikuar të shpenzimeve të thesarit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave nga të cilat nuk rezultuan devijime materiale.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mat si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik.

**Për vitin 2023**, planifikimi i buxhetit i rishikuar për zërin e shpenzimeve me të ardhurat e veta vendore, transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën specifiken ka vlerën 671,188 mijë lekë.

**Tabela Nr.5:**Paraqitet pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për vitin 2023, referuar situacionit të shpenzimeve dhe akt-rakordimit të të ardhurave me thesarin (të ardhurat e veta vendore + transfera e pakushtëzuar + transfertë sektoriale) paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Viti 2023 ne 000/leke					
		Plani fillim Sipas VKB	Çelja në Thesarit sipas akt rakordim	Fakti sipas aktrakordimit	Te ardhur veta	Grand	Trans. pakusht Spec.
1	Paga (600)	293,335	7,516	300,851	57,338	127,512	116,001
2	Sigurime (601)	48,986	1,255	50,241	9,575	21,294	19,372
3	Shpenzime (602)	75,910	47,520	123,430	37,074	56,362	29,994
4	Shpenzime (604)	22,105	201	22,306	2,200	20,106	
5	(604) F. Rezervë	5,000	-	5,000		5,000	
6	Inv(230 +231)	70,684	94,499	165,183	81,100	66,990	17,093
7	Transferta 606	4,177	-	4,177		4,177	-
<b>Totali</b>		<b>520,197</b>	<b>150,991</b>	<b>671,188</b>	<b>187,287</b>	<b>301,441</b>	<b>182,460</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

**Tabela Nr.6:**Paraqitet pasqyra e realizimit të shpenzimeve të financuara me fonde të kushtëzuara:

Emërtimi	Viti 2023 ne 000/leke			
	Çelja në thesarin sipas akt rakordimit PLAN	Fakti sipas aktrakordimit FAKT	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Per inves
Paga (600)	6,495	5,714	6,495	
Sigur. (601)	1,085	954	1,085	
Shpenz (602)	2,187	2,055	2,187	
Shpenz (604)	5,139	2,352	5,139	
(604) F. Rez				
Inv(230 +231)	729,092	700,383		729,092
Transferta 606	381,152	364,047	381,152	
<b>Totali</b>	<b>1,125,150</b>	<b>1,075,505</b>	<b>396,058</b>	<b>729,092</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

Sipas akt-rakordimit shpenzimet vjetore në vitin 2023 janë në vlerën 1,631,891 mijë lekë

**Tabela Nr.7:**Paraqitet pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha vitin 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin duke përfshirë fondet e kushtëzuara paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Emërmi	Viti 2023: ne 000/lekë								
	Plani fillim Sipas VKB	Çelja në thesar	Sipas akt-rak Plan Thesar	Totali i faktit Situacioni 2023	Të ardh veta	Grand	Trans. pakushte z Spec.	Tran. Kusht.	Tra. Kush Për inv.
600	293,335	14,011	307,346	306,182	57,276	127,395	115,798	57,13	
601	48,986	2,340	51,326	51,132	9,565	21,275	193,38	954	
602	75,910	49,707	125,617	101,533	26,856	49,342	23,281	2,054	
604	22,105	5,340	27,445	22,656	200	20,105		2,351	
604	5,000	-	5,000	0					
230+ 231	70,684	823,591	894,275	783,719	30,195	49,523	3,618		700,382
606	4,177	381,152	385,329	366,669		2,622		364,047	

<b>Totali</b>	<b>520,197</b>	<b>1,276,14</b> <b>1</b>	<b>1,796,338</b>	<b>1,631,89</b> <b>1</b>	<b>124,09</b> <b>2</b>	<b>270,262</b>	<b>162,035</b>	<b>396,058</b>	<b>700,382</b>
---------------	----------------	-----------------------------	------------------	-----------------------------	---------------------------	----------------	----------------	----------------	----------------

### **Burimi:**Bashkia Mat

Buxheti përfundimtar për vitin 2023 i Bashkisë Mat me burim të ardhurat e veta, transfertën e pakushtëzuar, transfertën e kushtëzuar specifike, dhe transfertën e kushtëzuar për investime është realizuar 91 % ose për vlerën 1,631,891 mijë lekë nga 1,796,338 mijë lekë planifikimi, ose mos realizim në vlerën 164,447 mijë lekë, me hollësisht sipas artikujve:

- Shpenzimet për paga (600) janë realizuar në masën 100 % ose në vlerën 306,182 mijë lekë nga 307,346 mijë lekë të planifikuara, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 57,276 mijë lekë, nga granditë në vlerën 127,395 mijë lekë, nga transfertat e pakushtëzuar specifike 115,798 mijë lekë dhe nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 5,713 mijë lekë.

- Shpenzime për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore 601“*Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*” janë realizuar në masën 100 % ose në vlerën 51,132 mijë lekë nga 51,326 mijë lekë planifikimi, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 9,565 mijë lekë, nga granditë në vlerën 21,275 mijë lekë, nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 19,338 mijë lekë dhe nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 954 mijë lekë.

- Shpenzimet operative (602) janë realizuar në masën 81 %, ose në vlerën absolute 101,533 mijë lekë nga 125,617 mijë lekë të planifikuara, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 26,856 mijë lekë, nga granditë në vlerën 49,342 mijë lekë, nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 23,281 mijë lekë dhe nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 2,054 mijë lekë. Konstatohet se ka diferencë midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve operative. Mos realizimi i këtij artikulli 602 ka ardhur si pasojë e një planifikimi jo të studiuar.

- Shpenzime për investime (231+230) janë realizuar në masën 88 %, ose në vlerë absolute 783,719 mijë lekë nga planifikimi 894,275 mijë lekë, me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 30,195 mijë lekë, nga granditë në vlerën 49,523 mijë lekë, nga transfertat e kushtëzuar specifike në vlerën 3,618 mijë lekë dhe nga transfertat e kushtëzuar për investime në vlerën 700,383 mijë lekë. Një vend të konsiderueshëm përveç investimeve të vitit ushtrimor kanë edhe likuidimet e prapambetura të investimeve për llogaritë të viteve të mëparshme.

Mos realizimi i buxheteve nga Bashkia Mat vjen si rezultat i mos realizimit të të ardhurave nga taksat/tarifat vendore dhe planifikimi i këtyre shpenzimeve mbi bazën e planit të të ardhurave me fryrje, ku kjo bashki për asnjë nga vitet ushtrimore të mbyllura nuk ka realizuar të ardhurat e planifikuara. Veprime në kundërshtim me ligjin 68/2017 datë 27.04.2017 “*Për financat vetëqeverisjes vendore*”, neni 46.

Bashkia Mat nuk ka marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i shpenzimeve që mbulohet nga të ardhurat e veta të bëhet mbi baza reale të të ardhurave të grumbulluara në vitin ushtrimor të mbyllur dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve buxhetore, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga ardhurat veta.

- “Transferime korentë të brendshme”, artikulli 604 është planifikuar në vlerën 5,000 mijë lekë dhe është përdorur i plote, trajtuar me hollësisht me poshtë.

- “Transferime për buxhete familjare dhe individë”, Artikulli 606, është planifikuar në vlerën 385,329 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 366,669 mijë lekë, e përbërë nga funksione të deleguara në vlerën 364,047 mijë lekë dhe nga Granditë për 2,622 mijë lekë. Shpenzimet për ndihmën ekonomike dhe paafëtisë për vitin 2023 në Bashkinë Mat mbulojnë: 1,607 familje në nevojë ekonomike për qytetin dhe 7 njësitë administrative, 1,280 persona me aftësi të kufizuara (PAK) dhe 149 familje përfituese me 6 %.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë, kontigjencës dhe emergjencë:

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njësite të qeverisjes vendore, është krijuar fondi rezervë.

Në buxhetin e Bashkisë për vitin 2023, është planifikuar fond rezervë nga granti.

Fondi rezervë dhe i kontigjencës i planifikuar paraqitet në vlerën 5,000,000 lekë, miratuar me VKB 37 date 29.03.2022 “Për buxhetin afatmesëm 2023-2025” dhe me VKB nr. 134 datë 22.12.2022 “Për miratimin e buxhetit 2023” .

Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet fondi i kontingjencës.

Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përfshirë transfertat e kushtëzuara.

Fondi Rezervë për periudhën e vitit 2023 është përdorur për vlerën 5,000,000 lekë për ndihmën e familjeve në nevojë, bashkëfinancim për rikonstruksionin e ish-hotelit Uzinës dhe transferta për sportin, me miratim të Këshillit Bashkiak, konkretisht:

- vlera 250,000 lekë, ndihma financiare sipas VKB nr. 16 datë 27.02.2023.
- vlera 140,000 lekë, ndihma financiare sipas VKB nr. 26 datë 25.04.2023.
- vlera 260,000 lekë, ndihma financiare sipas VKB nr. 35 datë 29.09.2023.
- vlera 1,000,000 lekë, bashkëfinancim rikonstruksion ish-hoteli i Uzinës, sipas VKB nr. 16 datë 13.07.2023.
- vlera 2,000,000 lekë, transferta për sportin, sipas VKB nr. 31 datë 08.09.2023.
- vlera 20,000 lekë, ndihma financiare, sipas VKB nr. 47 datë 30.11.2023.
- vlera 1,330,000 lekë, paga e sigurime shoqërore, sipas VKB nr. 47 datë 30.11.2023.

Fondi i Emergjencës për vitin 2023 është planifikuar për vlerën 4,000,000 lekë, pasqyruar dhe në raportin e monitorimit 2023, sipas shkresës nr.857 date 28.02.2024.

Fondi Emergjencës është përdorur me miratim të Këshillit Bashkiak për vlerën 1,964,986 lekë, sipas rasteve, konkretisht:

- vlera 404,335 lekë, supervizim Ura “Pasarelë” Stojan, sipas VKB nr .17 datë 13.07.2023.
- vlera 60,651 lekë, kolaudim Ura “Pasarelë” Stojan, sipas VKB nr .17 datë 13.07.2023 .
- vlera 1,200,000 lekë, blerje nafte emergjencë, sipas VKB nr .17 datë 13.07.2023
- vlera 300,000 lekë, ndihmë financiare për dëmtim banese nga rrëshqitja e tokës për A N, sipas VKB nr.11 datë 27.01.2023.

Gjatë vitit 2023 janë planifikuar të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore shuma 155,937 mijë lekë dhe realizimi është në shumën 141,539 mijë lekë.

**Tabela Nr.8:** Planifikimi dhe Realizimi i të ardhurave vendore

Nr	Emërtimi	Plan 2023	Fakt 2023	%
1	Të ardhura tatimore	48,856,000	43,066,223	88%
2	Të ardhura jotatimore	104,306,749	97,229,445	93%
3	Sponsorizime	2,775,000	1,244,000	45%
<b>Shuma</b>		<b>155,937,749</b>	<b>141,539,668</b>	<b>91%</b>

Burimi: Bashkia Mat

Të ardhurat nga burimet e veta vendore për 12 mujorin 2023 janë realizuar në vlerën 141,539,668 lekë, e ndare sipas llojit të të ardhurave:

- Të ardhura tatimore në shumën 43,066,223 lekë,
- Të ardhura jo tatimore në shumën 97,229,445 lekë, sipas të dhënave të mësipërme % më të lartë të realizimit e kanë të ardhurat jo tatimore në masën 93%.
- Sponsorizimet në shumën 1,244,000 lekë.

Në **aneksin nr. 2/1/3.** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit paraqitet akt rakordimi vjetor i të ardhurave vendore për vitin 2023 me Thesarin Mat

#### **2.1.4. Programimi i nevojave dhe përgatitja e regjistrit të prokurimeve, celja e fondeve dhe realizimi i tyre.**

Investimet në Bashkinë Mat janë realizuar 88 % ose në vlerë absolute 783,719,000 lekë nga 894,275,000 lekë planifikimi, për vitin 2023

Peshën kryesore ndaj shpenzimeve gjithsej e zë zëri investime për vlerën 783,719 mijë lekë nga 1,631,891 mijë lekë shpenzimet gjithsej, ose gjysma e buxhetit në masën 48 %.

Në likuidimet e investimeve për vitin 2023, vend të konsiderueshëm kanë edhe likuidimet e prapambetura të investimeve për llogari të viteve të mëparshme.

Investimet e vitit 2023 sipas burimit të financimit, paraqiten:

\* me fonde të deleguara janë realizuar 700,382,977 lekë nga 729,091,860 lekë planifikimi.

\* me fonde të buxhetit të Bashkisë (ardhura vendore + grand) janë realizuar 83,336,923 lekë nga 165,183,140 lekë planifikimi, pra investimet e planifikuara me fondet e veta të Bashkisë nuk janë realizuar, pasi nuk janë realizuar të ardhurat vendore dhe grandit. Të ardhurat vendore janë realizuar 141,539,668 lekë, nga kjo vlera 28,185,749 lekë është financim nga institucione tjera (këtu përfshihen të ardhurat nga qarku për 1,244,000 lekë dhe fondi AZHBR për 26,941,749 lekë), pra mbeten të ardhura vendore realizuar 113,353,919 leke nga 127,752,000 lekë planifikimi.

Programimi i nevojave për investime dhe realizimi i tyre si dhe çelja e fondeve, sipas regjistrit të prokurimeve, paraqitet në **aneksin nr.2/1/4** bashkëlidhurbashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

#### **2.1.5.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore,**

**raporti i tyre me shpenzimet e vitit sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve të FZHR dhe Ministrisë e Linjës.**

Detyrime të prapambetura të pa likuiduara paraqiten në 36 raste gjithsej për vlerën 29,073,330 lekë deri më datë 31.12.2023 nga Bashkia Mat.

Detyrimet e prapambetura prej 29,073,330 lekë sipas llojit detyrimeve në mënyrë të grupuar, paraqiten sa vijon:

- Fatura të pa likuiduara për mallra paraqiten 11 raste për vlerën 420,155 lekë.
- Fatura të pa likuiduara për shërbime të ndryshme paraqiten 14 raste për vlerën 4,846,165 lekë.
- Fatura të pa likuiduara për investime paraqiten 7 raste për vlerën 14,869,809 lekë.
- Vendime gjyqësore të pa likuiduara paraqiten 4 raste për vlerën 8,937,201 lekë,

#### **Vonesa në likuidimin e faturave.**

Bashkia Mat paraqet vonesa në likuidimin e faturave të subjekteve për vitin 2023, pasi i përkasin vitit 2023 dhe 2022, pra nuk janë likuiduar brenda afatit ligjor, sipas pasqyrës nr.2/1/5 në aneksët e raportit të auditimit, në kundërshtim me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe në nenin 52 të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, i ndryshuar.

Fatura e palikujduara të cilat e kanë kaluar afatin 60 dhe janë raportuar si detyrim i prapambetur paraqiten në **aneksin nr. 2/1/5** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

#### **Vendime gjyqësore.**

Bashkia Mat për vitin 2023 paraqet vendime gjyqësore 4 raste për vlerën 8,937,201 leke, e ndare në:

2 raste për vlerën 5,747,591 lekë, detyrime për dëmshpërblim page, për punonjësit e larguar nga puna (B dhe A.D), çka ka shkaktuar dublim pagese për të njëjtin vend pune dhe ka dhënë ndikim negativ në buxhetin e bashkisë,

2 raste për vlerën 3,189,610 lekë, detyrime kontraktore për 2 subjekte (Zyra Përmb+ FSHF).

**Pasqyra analitike e 4 vendimeve gjyqësore për vlerën 8,937,201 leke**, sa vijon:

**Tabela Nr.9:Paraqiten vendimet gjyqësore ndaj Bashkisë Mat**

Objekti	Kreditori	Shuma lekë
Vendime gjyqësore nr. 116 datë 06.06.2019	Zyra Permbarim Burrel	112,000
Vendime gjyqësore nr. 631 datë 04.02.2019	F.E.G	3,077,610
Vendime gjyqësore nr. 3562 datë 18.07.2017	B	2,881,991
Vendime gjyqësore nr.333 datë 27.04.2023	A.D	2,865,600
<b>Shuma</b>		<b>8,937,201</b>

Nga auditimi konstatohet se: vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga ish-Kryetari i Bashkisë dhe kryetari aktual, nuk është kërkuar prej tyre nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare me efekt negativ në buxhet për vlerën 8,937,201 lekë.

Veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60, me udhëzimin nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit” pika 6.1 “Vendimet gjyqësore” dhe pika 62 e UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me UMFE nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

### **Vështirësia Financiare e Bashkisë Mat.**

Bashkia Mat nuk është në vështirësi financiare, pasi detyrimet e prapambetura janë në masën prej 5 % ndaj shpenzimeve gjithsej, ose nën kufirin ligjor prej 25 % (detyrimet = 29,073 mijë lekë : 671,188 mijë lekë shpenzimet gjithësej), sipas kërkesave të nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”.

Bashkia Mat ka raportuar detyrimet e prapambetura periodikisht në MFE, DPB dhe DFV për vitin 2023, në përputhje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” neni 48, me ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 65, me ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 44, me UMFE 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit buxhetit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde Monitorimit Buxhetit Njësitë Qeverisjes Vendore”.

Për vitin 2023 nga Bashkia Mat administrohen 3 raportet të monitorimit dhe të zbatimit të buxhetit dhe detyrimeve të prapambetura si më poshtë:

Vlera është raportuar nga Bashkia Mat në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe Drejtorinë Financave Vendore me shkresën nr. 2106 datë 30.05.2023, për detyrimet e prapambetura Janar-Prill 2023.

Vlera është raportuar nga Bashkia Mat në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe Drejtorinë Financave Vendore me shkresën nr. 5181 datë 28.09.2023, për detyrimet e prapambetura Maj-Gusht 2023.

Vlera është raportuar nga Bashkia Mat në adresë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Përgjithshme Buxhetit dhe Drejtorinë Financave Vendore me shkresën nr. 857 datë 28.02.2024, për detyrimet e prapambetura të vitit 2023 për vlerën 29,073,330 leke, sipas llojit tyre, të cilave u ka kaluar afatin 60-ditor i likuidimit.

Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon:

**Në Pasqyrën Nr. 10:** Stoku i detyrimit të mbetur rakordon me vlerën e detyrimeve në sistemin e thesarit si vijon

Nr	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>	<b>0</b>		

a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
<b>II</b>	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>29,073,330</b>		<b>5.84%</b>
<b>Llogaria ekonomike</b>	<b>Emërtimi</b>			
4864100	Vendime Gjyqësore	8,937,201		
4864200	Det.Prap. Shërbime	4,846,165		
4864201	D.P.Energji Elektrike			
4864300	Det.Prap. Mirëmbajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	14,869,809		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra	420,155		
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendetëçore			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personale			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronësime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>29,073,330</b>	<b>498,227,234</b>	<b>5.84%</b>

**Burime:** Bashkia Mat

Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimet totale të miratuara, ka vlerën 5.84 %, shifër që e klasifikon Bashkinë Mat në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare.

Referuar kontratave të investimeve aktive në Bashkinë Mat rezulton se stoku i detyrimeve të prapambetura është raportuar në përputhje me udhëzimin nr.37, datë 06.10.2020 “Monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”

### **Vendime shpronësimesh.**

Bashkia Mat për vitin 2023 nuk paraqet vendime shpronësimi, pasi nuk ka pasur dëmshpërblime të pronave private për interes publik

### **Celja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR.**

Investimet nga Fondi i Zhvillimit Shqiptar për vitin 2023 pasqyrohen sipas llojit tyre me vlerat përkatëse, sipas pasqyrës sa vijon:

**Në Pasqyrën Nr. 11:** Kontratat e investime të financuara me fonde të FZHR

<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>
1	Rikonstruksion shkolla Mustafa Gjestila	77,401,256	77,401,256
2	Blerje pajisje mobilje per shkollat	8,822,184	8,822,184
3	Rikonstruksion shkolla 28 Nentori	61,085,392	61,085,392
4	Rikonstruksion shkolla Pjeter Budi	39,753,763	39,753,763
5	Ndertim Ujesjej Derjan Rukaj Loti I	126,585,766	126,585,766
6	Ndertim Ujesjej Derjan Rukaj Loti II	77,500,000	77,500,000
7	Ujesjellesi Burrel faza I&II	282,006,045	282,006,045
8	Mbikeqyrje Ujesjellesi Derjan Rukaj loti II	900,000	900,000
9	Mbikeqyrje Ujesjellesi Burrel faza I faza II	500,000	500,000
10	Mbikeqyrje Ujesjellesi Derjan Rukaj Loti I	900,000	900,000
11	Rik Ish Hoteli Uzines	35,258,640	18,426,840
12	Rik Ura pasarele Stojan	18,378,809	6,501,731
<b>13</b>	<b>Shuma</b>	<b>729,091,855</b>	<b>700,382,977</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Për vitin 2023 Bashkia Mat ka pasur çelje nga fondet e FZHR duke realizuar vlerën 700,382,977 leke investime nga 729,091,855 te planifikuara.

Investimet nga Fondi Zhvillimit Shqiptar për 2023 paraqiten gjithsejtë 12 projekte, nga këto:

- Ndërtim Ujësjiellësish( Derjan Rukaj loti I dhe II, Burrel loti I dhe II, - Rikonstruksion Shkollash,
- Ura “Pasarele”, - Rikonstruksion ish-hoteli i uzinës, - Pajisje me Mobilieri për shkollat, - Mbikëqyrës dhe tjerë.

### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:**

- 1.Znj. D.T, Drejtor i Financës në cilësinë e nënpunësit zbatues.
- 2.Znj. L.K, Përgjegjëse e Sektorit të Pastrimit të Mbetjeve Urbane
- 3.Z. E.R, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve
- 4.Znj. M.L, Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve
- 5.Z. P.C, Përgjegjës i MKZ

## **2.2.Burimi i krijimit i të të ardhurave dhe mbledhje e tyre**

**2.2.1** Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave

**2.2.2** Mënyra e llogaritja dhe vlerësimi i të ardhurave sipas zërave (taksa/tarifa), në zbatim të paketës fiskale sipas programit të auditimit.

**2.2.3** Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**2.2.4** Evidentimi i debitorëve të pa arkëtuara progresivë dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.

Në zbatim të pikës së mësipërme të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Mat për miratimin e paketës fiskale të vitit 2023, me ndryshime;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj;
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave, dosje fizike të mbajtura për subjektet tatimpagues;
- Relacione periodike të punës së kryer për periudhën objekt auditimi nga specialistët e pranifaturimit dhe specialistët e kontrollit në terren dhe evidencat e korrespondencat zyrtare për ndjekjen e debitorëve;
- Kontrata, aktmarrëveshje, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Pasqyrat financiare për vitin 2023. Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2023;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe zyra e tatim-taksave.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:***

### **Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore,**

Për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Urdhrin nr. 16, datë 10.01.2023 me nr. 92 prot., datë 10.01.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Mat” i ndryshuar me Urdhrin nr. 439 datë 11.09.2023 dhe urdhrin nr. 4704 prot., datë 11.09.2023 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Bashkisë Mat”, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë Ekonomike dhe e të Ardhurave/Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore i ndryshuar me Sektorin e Tatimeve dhe Taksave Vendore. Ky sektor bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë pranë bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, ku roli i këtyre sektorëve është

hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben taksapaguesve për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Struktura e sektorit të tatim-taksave për vitin 2023 është paraqitur në **aneksin nr. 2/2/1** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

- Sektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore/ Bashkia Mat, për vitin 2023 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore.

Përveç sektorit të tatimeve dhe taksave vendore, në Bashkinë Mat janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, sipas specifikave si më poshtë vijon:

Në **Pasqyrën Nr.1** më poshtë janë paraqitur strukturat përgjegjëse për mbledhjen e taksave sipas paketës fiskale për vitin 2023.

Struktura	Lloji i të ardhurës
Drejtoria Ekonomike dhe e të Ardhurës/Sektori i Taksës së Pronës	Taksa e pronës
Drejtoria Juridike dhe e Taksave Vendore/Sektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore	Taksat dhe tarifave vendore për biznesin dhe familjarët
Drejtoria e Urbanistikës	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale
	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi
	Certifikatë përdorimi
Drejtoria e Bujqësisë dhe e Shërbimit Pyjor	Qira për fond pyjor dhe kullosor
	Shitja e lëndës drusore
	Shitja e prodhimeve pyjore
	Taksa nga Toka bujqësore
IMTV	Gjoha për ndërtime pa leje etj
MZSH	Tarifa sherbimesh
Policia Bashkiake	Gjoha kundërvajtjeje

**Punoi:** Grupi i Auditimi

Rikompozimet në strukturën e taksave vendore dhe vakanca e krijuar prej një periudhe afro 2 vjeçare e pozicionit të përgjegjësit të saj, ndryshime të cilat nuk janë pasqyruar në rregulloren e brendshme të Bashkisë Mat, përbën një nga arsyet kryesore e situatës në mbledhjen e të ardhurave nga taksa e tarifa vendore, pasi është shoqëruar me mungesën e analizës së veprimtarisë, hartimit të raporteve në kohë e me informacion real dhe ndjekjes së hapave të procedurave administrative e ligjore, në mospërmbushje të kuadrit ligjor dhe Rregullores së Brendshme të njësisë, miratuar me Urdhrin nr. 717 datë 24.11.2016, neni 90.

Në fillim të çdo viti Drejtoria Ekonomike dhe e Taksave bën raportimin vjetor mbi analizën e të ardhurave vjetore të bashkisë, i cili është pjesë e Raportit vjetor të Monitorimit dhe e Raportit të buxhetit që prezantohet në Këshillin Bashkiak.

Paketa fiskale për vitin 2023 është miratuar me VKB nr. 117 datë 25.11.2022 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresën nr. 1201/1 prot., datë 07.12.2022, konform kuadrit ligjor në fuqi.

Nga auditimi rezultoi se Rregullore e Brendshme e miratuar me Urdhrin nr. 717 datë 24.11.2016 dhe VKB nr. 117 datë 25.11.2022 e miratimit të paketës fiskale për vitin 2023 nuk janë regjistruar në regjistrin e protokollit të Bashkisë Mat, në moszbatim të dokumentit "Norma Teknike profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë", neni 19; Vendim nr. 4, datë 19.06.2017 "Për miratimin e "rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" Model 3;

Në **Pasqyrën Nr.2** është paraqitur informacioni sipas njësive administrative dhe numrit të abonentëve familjarë/biznes.

Bashkia Mat - Viti 2023						
Qarku	Qendra e Bashkisë	Nr	Njësi Administrative	Nr. Fshatra/lagje	Nr. Banorë	Klasifikim taksapagues
Dibër	Burrel	1	Burrel	1	38,615	537 BV
		2	NJA Baz	5		
		3	NJA Derjan	7		146 BM
		4	NJA Rukaj	6		

	5	NJA Macukull	5		24 B VIP
	6	NJA Komsí	10		
	7	NJA Lis	7		
	8	NJA Ulëz	6		
	8	<b>Totali</b>	<b>47</b>		<b>12,000 Familje</b>

**Puno:** Grupi i auditimit

Informacioni përmbledhës për paketën fiskale dhe sektorët e ngarkuar për arkëtimin e të ardhurave është paraqitur në **aneksin nr. 2/2/2** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

### **Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.**

Paketa fiskale 2023 është miratuar me VKB Nr. 117, datë 25.11.2022 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me nr. 1201/1 prot., datë 07.12.2022 konform kuadrit ligjor në fuqi. Nga të dhënat e paraqitura në **aneksin 2/2/3** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit, rezulton se për vitin 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifatat janë realizuar në vlerën 106,983 mijë lekë ose në masën 86.5%; për vitin 2023 janë realizuar në vlerën 113,353 mijë lekë ose në masën 88.7%. Pra nga viti 2022 në vitin 2023 ka patur një rritje të të ardhurave prej kundrejt planifikimit prej 2.2%.

Për vitin 2023, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 127,752 mijë lekë ose 4,005 mijë lekë më shumë se viti 2022 dhe janë realizuar në vlerën 113,353 mijë lekë ose 6,370 mijë lekë më shumë se viti 2022;

Realizimi i të ardhurave për vitin 2023 është në masën 88.7%; ndërsa për vitin 2022 është në masën 86.5%;

-Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, me ndryshimet në kuadrin ligjor tatimor nuk planifikohet, por rezulton se për vitin 2023 janë arkëtuar 282,388 lekë, të cilat janë detyrime të prapambetura.

### **Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023**

Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar vlerë për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse rezulton si mëposhtë vijon:

- TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 8,739 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 3,397 mijë lekë ose 38.9% e vlerës së planifikimit, me 3,417 mijë lekë më pak se në vitin 2022;
- Taksë e zënies së hapësirës publike për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 2,581 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,715 mijë lekë ose në masën 66.5%, me një vlerë 1,727 mijë lekë më pak se në vitin 2022;
- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 11,438 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 13,300 mijë lekë ose në masën 116.3% të tij, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej 157.3 mijë lekë më pak se në vitin 2022;
- Taksa e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 731 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 466 mijë lekë ose në masën 64%, krahasuar me vitin 2022 ka një rënie prej 34 mijë lekë.
- Taksë trualli është parashikuar në vlerën 1,294 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 2,665 mijë lekë ose në masën 206%, me një rritje të ardhurash prej 993 mijë lekë nga viti 2022;
- Taksë reklame është parashikuar në vlerën 830 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 514 mijë lekë ose në masën 62% dhe krahasuar me vitin 2022 është ulur me një vlerë prej 166 mijë lekë;
- Taksë tabele është parashikuar në vlerën 156 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 78 mijë lekë ose në masën 50.2%, krahasuar me vitin 2022 rezulton në rënie me një vlerë prej 72 mijë lekë;
- Taksë fjetje në hotel është parashikuar në vlerën 105 mijë lekë dhe është realizuar 0 (zero) lekë ose 0% realizim, është e njëjta vlerë si edhe në vitin 2022, pra pa arkëtim.

- Taksë e mjeteve në qarkullim është parashikuar në vlerën 11,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,703 mijë lekë ose në masën 115.5% , krahasuar me vitin 2022 është 246 mijë më pak;
- Taksa e rentës minerare, është parashikuar në vlerën 530 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 122 mijë lekë ose në masën 23%, krahasuar me vitin 2022 rezulton me 117 mijë lekë më shumë;
- Taksa e kalimit të pronësisë për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 12 mijë lekë dhe realizuar në vlerën 0 (zero) lekë ose në masën 0%. Duhet theksuar se për vitin paraardhës 2022 vlera e arkëtimeve nga kjo taksë për llogari të Bashkisë Mat ka qenë më e lartë në shumën 3,489 mijë lekë;
- Taksë e përkohshme vendore për infrastrukturën arsimore rezulton se nuk është përfshirë në listën e taksave të miratuara në paketën fiskale të vitit 2023, dhe është parashikuar në vlerën 0 (zero) lekë, por pavarësisht këtij fakti ajo është vjelë në vlerën 855 mijë lekë, krahasuar me vitin 2022 janë arkëtuar 850 mijë lekë më shumë; kjo taksë ka qenë e miratuar me VKB në paketat fiskale të vitit 2020, 2021 dhe 2022 dhe se arkëtimi i saj në vitin 2023 ka ardhur nga detyrimi i papaguar në vitet paraardhëse.
- Leje shfrytëzim karburanti është parashikuar në shumën 5,208 mijë lekë dhe është realizuar në shumën 1,900 mijë lekë ose në masën 36.5%, por rezulton se krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje me shumën 1,100 mijë lekë;
- Qira nga ndërtesat është parashikuar 2,092 mijë lekë dhe janë arkëtuar 568 mijë lekë ose në masën 27.2%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje në shumën 294 mijë lekë;
- Qira tokë bujqësore është parashikuar në vlerë 0 (zero) lekë dhe realizuar në shumën 10 mijë lekë, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje prej 10 mijë lekë më shumë, pasi në vitin 2022 nuk ka patur arkëtime.
- Qira për troje është parashikuar në vlerën 4,776 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 1,237 mijë lekë ose në masën 18.8%, krahasuar me vitin 2022 arkëtimi është në të njëjtën vlerë prej 1,237 mijë lekë.
- Gjithashtu, nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore është i dokumentuar. Ka komunikim të dokumentuar të Sektorit të Taksave dhe Tarifave vendore me drejtoritë brenda bashkisë, njësitë apo strukturat në varësi nëpërmjet kërkesës për informacion lidhur me hartimin e paketës fiskale për vitin 2023, krahas tyre është hartuar edhe nga analiza e të dhënave dhe trendi i të ardhurave të viteve paraardhëse.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura, analizës së përshkruar si dhe shqyrtimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin që metodologjia e përdorur nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore, nuk ka mundur të parashikojë saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Veprime këto në kundërshtim me VKB-në nr. 117, datë 25.11.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mat, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”. Në kundërshtim me rregulloren e brendshme *neni 90 pika (e) detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit ku citohet...* “*Të miratojë planin vjetor të punës dhe planin e të ardhurave tatimore për sektorin e tatimeve*”..etj.

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblihet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Mat”, për llogari të Bashkisë Mat. Akt rakordimi përcillet në rrugë elektronike nëpërmjet adresës zyrtare të DRSHTRR. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “*Për taksat kombëtare*”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “*Të ardhurat nga taksat e ndara*” të ligjit nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njërive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Akt rakordimi me agjentin tatimor DRSHTRR *nuk hartohet sipas formatit zyrtar të miratuar nga MFE.*

**Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Në Rregulloren e Brendshme të institucionit të miratuar nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimit nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e akt-rakordimeve me ta, si dhe krijimin e një regjistri me të dhëna respektivisht nga agjentët:

**1.** Taksat vjetore të mjeteve të përdorura, mblihet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor Mat”, për llogari të Bashkisë Mat. Akt-rakordimi përcillet në rrugë elektronike nëpërmjet adresës zyrtare të DRSHTRR. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës “b”, të pikës 2, në nenin 25 “Të ardhurat nga taksat e ndara” të ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njërive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Akt-rakordimi me agjentin tatimor DRSHTRR nuk hartohet sipas formatit zyrtar të miratuar nga MFE.

**2.** Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblihet nga Agjenti Tatimor “Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër”. Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël” Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qendrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Në Bashkinë Mat rakordimet bëhen nga Sektori i Financës. Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023.

**3.** Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblihet nga Agjenti Tatimor “Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” tani ASHK Vendore. Deri tani ASHK Vendore nuk ka patur bashkëpunim me Bashkinë Mat. Nuk është arritur asnjë bashkëpunim mes tyre. për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimit e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Mat me vlerën e përlllogarit. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. U konstatua se deri në 31.12.2023 rakordimet me ASHK Vendore, për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nuk janë kryer;

**4.** Bashkia Mat duhet të vjelë rentën minerare, për shtatë subjekte të regjistruara për aktivitete shfrytëzimi të vendburimeve me minerale brenda territorit të Bashkisë Mat. Bashkia Mat dhe STTV ka informacion mbi aktivitetin e këtyre 7 subjekteve, por STTV ka realizuar akt rakordimet mujore me Drejtorinë e Doganave dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore, duke mundur të ketë informacion të detajuar mbi saktësinë e vlerës që paguhet nga subjektet për llogari të Bashkisë Mat.

Grupi i auditimit ka verifikuar nga Regjistri i lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore)<sup>4</sup>.

**5.** Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Mat ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor, në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar. Rezulton se Akt Rakordimet janë bërë konform formatit të miratuar nga MFE.

<sup>4</sup><http://ëëë.akbn.gov.al/regjistri-i-lejeve-minerare-aktive-shkurt-2023>

### **Administrimi i taksave dhe tarifave vendore**

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizikë/juridikë dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj., në Bashkinë Mat kryhet në programin Excel. Zyra e Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve kryhen regjistrim manual të të dhënave (nuk disponon regjistra fizik). Çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative, ndërmarrjet e varësisë dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Mat i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Të dhënat janë regjistra në formë tabelore dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve. Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve.

Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e Zyrës së Shërbimeve ndaj Tatimpaguesve për të cilat mund të ketë gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV.

Gjithashtu administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4, pika 7, ku përcaktohet që: “Pranë çdo bashkie dhe komune krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me Ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se gjatë vitit 2023, Bashkia Mat ka lidhur akt-marrëveshje me “Shoqërinë Ujësjiellës Kanalizime Dibër Sh.a”, për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore sipas paketës fiskale për abonentët familjarë të Bashkisë Mat.

### **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2023 në Bashkinë Mat, është si mëposhtë:

**Në Pasqyrën nr. 3: Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për vitin 2023.**

<b>Viti 2023</b>					
<b>Nr</b>	<b>Lloji Biznesit</b>	<b>Gjendja në fillim</b>	<b>Regjistrime reja</b>	<b>Mbyllur aktiviteti</b>	<b>Gjendja në fund të vitit</b>
<b>1</b>	Biznesi VIP	24	1	1	24
<b>2</b>	Biznesi i Madh	124	11	6	129
<b>3</b>	Biznesi i Vogël	512	49	57	504
<b>4</b>	Ambulant	52	0	5	47
<b>5</b>	Institucione	40	0	0	40
<b>(1+2+3+4+5)</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>752</b>	<b>61</b>	<b>69</b>	<b>744</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelë, rezulton se Bashkia Mat e ka mbyllur vitin 2022 me 752 biznese aktive në total, prej të cilëve: 24 biznese VIP, 124 BM, 512 BV, 52 Ambulantë dhe 40 Institucione;

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 61 biznese të reja nga të cilat 1 biznes -VIP, 11 -BM dhe 49 -BV dhe kanë mbyllur aktivitetin 69 biznese prej të cilëve: 1 biznes VIP, 6 BM, 57 BV, 5 Ambulantë. Bashkia Mat në fund të vitit 2023 ka të regjistruar në total 744 biznese ose 8 biznese më pak se në mbyllje të vitit 2022, prej të cilëve: 504 ose 8 më pak se në vitin 2022 janë biznes i vogël dhe 129 ose 5 më shumë se në vitin 2022 janë biznes i madh; 47 ose 5 më pak janë ambulantë.

Pra rezulton se numri total i subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, ka ardhur në rënie nga viti 2022 në vitin 2023 me një numër prej 8 biznesesh. Rënia e numrit të subjekteve shoqërohet edhe me rënie të vlerës së të ardhurave nga taksa e tarifat. Rezulton se nga DEA dhe STTV nuk ka një

analizë mbi arsyet e rënies së numrit të bizneseve gjë e cila do të sjellë hartimin e plan masave apo strategjive për mbështetjen e iniciativave për zgjerimin e aktivitetit tregtar në territorin e bashkisë si dhe në atë të vjeljes së taksave dhe tarifave vendore.

Subjekte fizike që kanë mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2023 në Bashkinë Mat janë paraqitur në **aneksin 2/2/4** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Subjekte fizike në numër dhe sipas llojit të aktivitetit në Bashkinë Mat janë paraqitur në **aneksin 2/2/5** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë rezulton se gjatë vitit 2023 kanë aplikuar dhe kanë pezulluar aktivitetin në QKB 49 subjekte, prej të cilave 24 subjekte janë pezulluar pa marrë paraprakisht vërtetimin mbi detyrimet ndaj Bashkisë Mat. Nga këto 24 subjekte, 3 prej tyre e kanë paguar detyrimin menjëherë sapo janë njoftuar. Vlera totale e detyrimit të 21 subjekteve të pezulluara deri në 31.12.2023 është në vlerën 3,477,088 lekë.

Kjo mungesë bashkëpunimi mes QKB dhe Bashkisë Mat ka sjellë vështirësi në arkëtimin e vlerës debitorë. STTV ka marrë masat administrative për arkëtimin e debisë duke dërguar njoftimet për shlyerjen e detyrimeve ë prapambetura.

### **Menaxhimi i borxhit:**

#### **Abonentët Familjarë:**

Abonentët familjarë debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Burrelit paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 55,759,890 lekë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga taksat dhe tarifave vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 17,981,545 lekë. Detyrimi i mbetur nga debia e akumuluar e viteve të mëparshme është në vlerën 37,778,345 lekë, gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 12,708,125 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 50,486,470 lekë nga taksat dhe tarifave vendore për 11,822 debitorë familjarë.

Në datën 31.12.2023 numri i debitorëve për taksa dhe tarifa vendore ka ardhur me rënie nga 15,005 debitorë në vitin 2022 në 11,822 debitorë në vitin 2023. Kemi ulje të debisë progresive me vlerën 5,273,420 lekë dhe ulje të numrit të debitorëve më 3,183

Analiza e lëvizjes së debitorëve familjarë:

- 3,985 debitorë “për taksë ndërtese familje” në vlerën 14,181,584 lekë ose 3,002 debitorë më pak se në vitin 2022 me një vlerë të debisë në rënie prej 373,881 lekë;
- 6,998 debitorë “taksa familjare” në vlerën 46,195,801 lekë ose 2,721 debitorë më pak se në vitin 2022 me një vlerë të debisë në rënie prej 3,934,471 lekë;
- 4,789 debitorë “për taksa tokë bujqësore” në vlerën 2,499,670 lekë ose 402 debitorë më pak se në vitin 2022 me një vlerë të debisë në rënie prej 102,481 lekë;
- 35 debitorë “për TNI” në vlerën 1,791,999 lekë ose 6 debitorë më shumë se në vitin 2022 me një rritje të vlerës së debisë prej 1,441,430 lekë;

Referuar informacionit të pasqyruar në tabelat përkatëse, rezulton se në total janë 12,000 abonentë familjarë që taksohen në Bashkinë Mat nga të cilët 6,998 abonentë familjarë janë debitorë për taksa/tarifa të ndryshme vendore ose 58.3% e tyre kanë detyrime ndaj saj.

Në **Pasqyrën Nr.4** më poshtë janë paraqitur të përmbledhura detyrimet e familjarëve progresive sipas njësive administrative për taksat dhe tarifave vendore.

Përshkrimi	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2022	Nr	Vlera e paguar në 2023 nga debia e 2022	Nr.	Borxhi i Krijuar gjatë vitit 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023
Debitorët taksat familje (truall, pastrim, ndriçim, gjelbërim, ndërtesë)	9719	50,130,272	2,721	16,006,494	6,489	12,072,023	6,998	46,195,801
Debitorët taksa e tokës bujqësore	5191	2,397,189	581	334,521	2,816	437,002	4,789	2,499,670
Debitorët taksa e ndikimit në infrast.	95	3,233,429	66	1,640,530	6	199,100	35	1,791,999
<b>Total Borxhi tatimor</b>	<b>15,005</b>	<b>55,759,890</b>	<b>3,368</b>	<b>17,981,545</b>	<b>9,311</b>	<b>12,708,125</b>	<b>11,822</b>	<b>50,486,470</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Vlera prej 50,486,470 lekë nuk është kontabilizuar dhe *konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Mat*, nga mos arkëtimi i taksës dhe tarifave nga debitorët familjarë deri në datën 31.12.2023. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar

**Abonentët privatë** debitorë në njësitë administrative dhe në qytetin e Burrelit paraqiten në fund të vitit 2022 për vlerën 45,441,358 lekë për 409 debitorë. Gjatë vitit 2023 pagesa për detyrime nga taksat dhe tarifave vendore të viteve të mëparshme kanë qenë në vlerën 13,308,015 lekë nga 188 debitorë. Detyrimi për vitet e mëparshme është në shumën 32,133,343 lekë gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime të reja në vlerën 8,537,880 lekë. Totali progresiv në fund të vitit 2023 është në vlerën 40,671,223 lekë i cili i përket 353 debitorë biznesi.

**Pasqyrën nr. 5:** Paraqitet informacion për subjektet debitorë biznes

Përshkrimi	Nr.	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2022	Nr	Vlera e paguar në 2023 nga debia e 2022	Nr.	Borxhi i krijuar gjatë vitit 2023	Nr	Vlera e borxhit progresive më 31.12.2023
Debitorë biznes VIP	8	7,069,743	5	4,702,960	3	1,257,050	3	3,623,833
Debitorë biznes i madh	39	16,727,915	20	2,607,887	3	3,432,174	58	17,552,202
Debitorë biznes i vogël	289	17,497,320	146	5,221,009	155	3,147,579	229	15,423,890
Lojëra Fati	10	722,515	0	0	0		10	722,515
Kompani Sigurimesh	1	5,000	0	0	1	55,600	2	60,600
Tregu industrial (Ambulant)	37	1,302,865	12	345,159	9	285,477	32	1,243,183
<b>Nëntotali I</b>	<b>383</b>	<b>44,415,158</b>	<b>183</b>	<b>12,877,015</b>	<b>171</b>	<b>7,892,403</b>	<b>334</b>	<b>38,626,223</b>
Institucioni	<b>26</b>	2,116,000	<b>5</b>	431,000	<b>13</b>	360,000	19	2,045,000
<b>Total Borxhi tatimor subjekte</b>	<b>409</b>	<b>45,441,358</b>	<b>188</b>	<b>13,308,015</b>	<b>184</b>	<b>8,537,880</b>	<b>353</b>	<b>40,671,223</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën e mësipërme, konstatohet se: në fund të vitit 2023 në Bashkinë Mat dhe 6 Nj.A, janë debitor 353 subjekte debitorë në vlerën totale 40,671,223 lekë ose 57 debitorë më pak se viti 2022 me rënie prej 4,740,135 lekë, e ndarë si më poshtë vijon:

- 3 subjekte “Biznesi Vip” në vlerën 3,623,833 lekë ose 5 debitorë më pak se në mbyllje të vitit 2022 me vlerë në rënie prej 3,445,910 lekë;
- 58 subjekte “Biznesi i Madh” në vlerën 17,552,202 lekë ose 19 debitorë më shumë se në vitin 2022 me vlerë në rritje prej 1,824,287;
- 229 subjekte “Biznesi i Vogël” në vlerën 15,423,890 lekë ose 60 debitorë më pak se viti 2022 me vlerë në rënie prej 2,073,430 lekë;
- 10 subjekte “Lojra Fati” në vlerën 722,515 lekë në të njëjtat kushte si edhe në vitin 2022;
- 2 subjekte “Kompani sigurimesh” në vlerën 60,600 lekë ose 1 debitor më shumë se në vitin 2022 me vlerë debie në rritje prej 55,600 lekë;
- 32 subjekte “Tregtar Ambulant/Tregu industrial” në vlerën 1,243,183 lekë deri në datë 31.08.2023 osë 5 debitorë më pak se në vitin 2022 me rënie të debisë prej 59,682 lekë;
- 19 subjekte “Institucione” në vlerën 2,045,000 lekë ose 7 debitorë më pak me rënie të debisë prej 71,000 lekë.

Për debitorët e krijuar më sipër, konstatohet se, nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për mos likuidim të detyrimit tatimor.

- Për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, nga bizneset, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifa Vendore, janë dërguar njoftim detyrimet për subjektet debitorë dhe më pas janë dërguar disa shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, barrë hipotekare në pasuritë e paluajtshme në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës/Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

Pra rezultoi se Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023, ka marrë masa vetëm lidhur me “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokim i llogarive bankare” si rezultat i masave të marra është mbledhur borxhi për vlerën 13,728,601 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal. Veprime në kundërshtim me Neni 76, neni 114, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën “c” të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar; Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; Shkronjën “a” të nenit 5, pikën 2 të nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; VKB nr. 117 prot., datë 06.12.2021.

Klasifikim i debitorëve të biznesit, sipas riskut të shlyerjes së detyrimit të mbartur është si më poshtë vijon:

Për biznesin e vogël

1. Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 46 subjekte në vlerën totale 5,363,323 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite janë 111 subjekte në vlerën totale 6,373,316 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë 72 subjekte në vlerën totale 3,991,436 lekë;

**229**

**15,728,075 lekë**

Për biznesin e madh

2. Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 34 subjekte në vlerën totale 16,190,190 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite janë 17 subjekte në vlerën totale 2,125,447 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë 7 subjekte në vlerën totale 399,300 lekë;

**58**

**18,714,937 lekë**

Për biznesin VIP

3. Debitorë pa shpresë arkëtimi janë 2 subjekte në vlerën totale 3,120,733 lekë;

Debitorë nga 3 deri në 5 vite janë 0 subjekte në vlerën totale 0 lekë;

Debitorë nga 2 deri në 3 vite janë 1 subjekte në vlerën totale 503,100 lekë;

**3**

**3,623,833 lekë**

Për subjekte e mësipërme debitorë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për arkëtimin e detyrimit ka ndjekur vetëm hapat si mëposhtë.

-Shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë, DSHTRR dhe në ASHK;

-Njoftimi i subjekteve debitorë dhe familjare kryhet me anë të shërbimit postar, por edhe nëpërmjet punonjësve të mbledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve.

Veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar. Udhëzim i përbashkët Nr.17, datë 20.06.2022 “Për përcaktimin e uniformitetin minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore”. III. Procedura për mbledhjen me masa shtrënguese të detyrimeve tatimore vendore.

**Taksa e tokës bujqësore:**

Referuar tabelës më poshtë rezultoi se vlera debitorë progresive për taksën e tokës bujqësore,

është nga 2,397,189 lekë në mbyllje të vitit 2022 dhe 2,499,670 lekë në mbyllje të vitit 2023, me një vlerë të debisë në rritje prej 102,481 lekë. Shuma 2,499,670 lekë e cila i përket 4,789 abonentëve familjarë është e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Mat. Theksojmë se, sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e vetëdeklarimeve të familjeve që përdorin tokë bujqësore, si dhe jo të jenë bërë verifikime me qëllim sigurimin e të dhënave dhe krijimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore, detyrë e Specialistit të Kadastrës dhe Menaxhimit të Tokës. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermerë që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri të madh i familjeve debitore në vlera të konsiderueshme debitore. Regjistrat nuk janë të përditësuar sipas ndryshimeve të bëra vit pas viti në kadastrë për tokat në disponim dhe përdorim. Nuk janë bërë në kohë njoftim detyrimet për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistrat, pasi faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë për shërbime të ndryshme.

Në **Pasqyrën nr. 6:** Paraqiten debitorët për taksën e tokës bujqësore

N.J.A.	Debi progresive deri në 31.12.2022	Familje me tokë bujqësore	Sip (m2)	Debitorë krijuar në vitin 2023 (Lekë)		Debia Progresive 31.12.2023
				Numri debitorë	Debia	
<b>Burrel</b>	218,158	235	1,032,335	110	45,398	
<b>Derjan/Macukull</b>	285,828	875	1,039,881	709	68,572	
<b>Ulëz</b>	42,449	292	273,314	189	9,394	
<b>Rukaj</b>	243,578	884	802,206	516	46,772	
<b>Lis</b>	428,784	887	1,766,922	563	94,661	
<b>Komsi</b>	750,955	1233	3,475,365	431	90,040	
<b>Baz</b>	427,437	785	1,771,846	298	82,165	
<b>Totali</b>	<b>2,397,189</b>	<b>5,191</b>	<b>10,161,869</b>	<b>2,816</b>	<b>437,002</b>	<b>2,499,670</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Në **aneksin nr.2/2/6** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit paraqitet informacion mbi ndarjes e tokës bujqësore në Bashkinë Mat.

Në **pasqyrën nr.7** paraqitet informacion lidhur me sipërfaqet e tokës bujqësore në pronësi.

Njësi Administrative/Institucion	Sipërfaqja në ha		
	Të ndara	Të pandara (Shtetërore)	
		Me origjinë nga ish.Koop.bujqësore	Me origjinë nga ish.Nb. bujqësore
Bashkia Mat	5,204	2631	405
<b>Totali</b>	<b>5,204</b>	<b>3,036</b>	

**Burimi:** Bashkia Mat

### **Tabela e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në Bashkinë Mat për vitin 2023**

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve rezultojnë se kjo drejtori nuk ka dërguar në Këshillin e Qarkut Dibër, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor.

Në **Pasqyrën nr.8** paraqitet informacion lidhur me sipërfaqet e tokës bujqësore në pronësi.

Njësi Administrative	Sipërfaqja në ha			
	Kullota	Pyje	Inproduktive	Shkëmbore e ujore
Bashkia Mat	2,999	2,7679	2,888	5.1

**Burimi:** Bashkia Mat

Nga auditimi rezultoi se nuk ka kontrata verore /dimërore të lidhura për shfrytëzimin e kullotave; Bashkia Mat nuk ka dhënë toka bujqësore me qira, pasi ende nuk ka përfunduar procesi i regjistrimit të tokave private dhe shtetërore sipas ligjit Nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

**Të ardhurat dhe vlerat debitore nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.**

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra vendore e ASHK Mat, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2023, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Mat deri në 31.12.2023, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Mat. Nga ZVASHK Mat, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësi Administrative të Bashkisë Mat, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Mat, nuk janë marrë masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ZVASHK Mat. Në **aneksin nr.2/7** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit paraqitet pasqyra e personave të cilët janë pajisur me leje legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën e vitit 2023, sipas tabelës përmbledhëse më poshtë Debitorë nga vitet e mëparshme në datë 01.01.2023 për taksën e infrastrukturës janë në vlerën 3,233,429 lekë dhe përbëhet nga 95 debitorë. Gjatë vitit 2023 kanë paguar për taksën e infrastrukturës 60 debitorë nga vitet e mëparshme në vlerën 1,640,530 lekë dhe për detyrimin e vitit 2023 kanë paguar 13 abonentë në vlerën 294,240 lekë.

Në datën 31.12.2023 për taksën e ndikimit në infrastrukturë kemi total debitorë 35 persona me vlerë 1,791,999 lekë shumë e cila është e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkinë Mat.

Në **Pasqyrën nr. 9** paraqiten të dhëna për taksën e infrastrukturës për vitin 2023:

Viti	Numri i objekteve të legalizuara që janë debitorë më 31.12.2022	Vlera e detyrimit më 31.12.2022	Pagesat 2023	Borxhi krijuar 2023	Totali detyrimit	Numri personave që kanë paguar 2023
2022	95	3,233,429	1,640,530	-	1,592,899	60
2023		-	294,240	199,100	199,100	13
<b>Totali</b>	<b>95</b>	<b>3,233,429</b>	<b>1,934,770</b>	<b>199,100</b>	<b>1,791,999</b>	<b>73</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga Bashkia Mat, u konstatua se, nuk janë marrë masat e nevojshme për vjeljen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet pa leje ndërtimi, të pajisura me leje legalizimi nga ZVASHK Mat konkretisht:

Për debitorët e mësipërm nuk janë marrë masat e nevojshme të përcaktuara në nenet 90-91 në Kreun XI të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Theksojmë se nga sektori i urbanistikës janë bërë njoftimet për pagesën e taksës, por në vijimësi nga sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk janë marrë të gjitha masat për arkëtimin në vlerë të plotë e debisë së kësaj takse

Nga dokumentacioni i paraqitur konstatohet se Bashkia Mat për periudhën ushtrimore nuk janë njoftuar subjektet debitorë si dhe nuk u evidentuan raste që Bashkia Mat të jetë drejtuar ASHK Dega Lushnje, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekare. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar, pika 5 dhe ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27.

### **Asetet e dhëna me qira:**

Bashkia Mat, në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre administron 19 kontrata për dhënien me qira të fondit pyjor/kullor. Bashkia Mat ka 16 kontrata aktive të lidhura përpara vitit 2023 me afat 10 vjeçar dhe për vitin 2023 ka lidhur 3 kontrata për dhënien me qira fondit pyjor kullor. Tarifa e përcaktuara në kontratat e lidhura gjatë vitit 2023 janë në përputhje me VKM

Nr. 54 datë 05.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”.

Nga auditimi i evidencave dhe informacioni i pasqyruar në **aneksin nr.2/8** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit rezulton se debia progresive deri në 31.12.2022 është 9,009,204 lekë për 11 subjekte dhe 9,555,857 lekë deri në 31.12.2023 për 13 subjekte, nga të cilat 4 subjekte janë debitorë të rinj.

- Gjithashtu janë në proces gjyqësor këto subjekte:

Subjekti N Shpk – Proces Gjyqësor – me debi - 2,745,385 lekë

Subjekti S Shpk me debi - 2,023,560 lekë

Subjekti A Shpk me debi - 4,382,117 lekë

Për këto kontrata të lidhura si dhe pagesat e bëra për qiranë jepen të dhëna në **aneksin nr.2/8** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

### **Tarifa e pastrim, gjelbërim, ndriçim , për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike.**

Nga auditimi lidhur me tarifën e pastrim, ndriçim, dhe gjelbërim, për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike rezultoi se gjatë viti 2023 kanë kryer punime ndërtimi 16 subjekte, nga të cilat 2 subjekte nuk kishin paguar detyrimin për vitin 2022. Konkretisht subjekti E shpk & E shpk dhe D Konstruktion, rezulton se e kanë paguar detyrimin në vitin 2023.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në **aneksin nr.2/9** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit rezulton se deri në 31.12.2023 nuk ka subjekte debitore për taksat vendore.

### **Debitor nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, rezulton se gjatë vitit 2023 janë vendosur 541 gjoba me vlerë totale 739,000 lekë dhe janë aplikuar 42 kamatvonesa në vlerën 27,450 lekë. Gjatë vitit 2023 janë paguar 163 gjoba me vlerë 258,450 lekë (me kamatvonesat). Debitorë për gjobat e vendosura nga policia bashkiake janë 378 persona me vlerë detyrimi 508,000 lekë.

Në **aneksin nr.2/10** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit paraqitet informacion mbi gjobat e vendosura nga policia bashkiake gjatë vitit 2023.

Në **Pasqyrën nr. 10** paraqiten të dhëna progresive për gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.

Emërtimi	Nr.	Shuma
Vlera progresive deri në 31.12.2022	2,549	1,693,000
Krijuar gjatë 2023	541	739,000
Kamatvonesa 2023		27,450
Paguar gjate 2023	163	258,450
<b>Totali progresiv</b>	<b>2,927</b>	<b>2,201,000</b>

**Punoi:** Grupi i Auditimit

Nga auditimi rezultoi se shuma e debisë progresive prej 2,201,000 lekë për 2,927 debitorë, deri në 31.12.2023 nuk është kontabilizuar dhe është e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Mat.

### **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Nga informacioni i pasqyruar në **aneksin nr.2/12** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit, rezulton se në Bashkinë Mat ushtrojnë aktivitetin e tyre 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekteve iu janë bllokuar llogaritë bankare dhe nuk janë pajisur me licensë për periudhën në vijim. Konstatohet se nga ana strukturave përgjegjëse të licencimit pajisja me leje nuk është bërë në çdo rast me afat 5 vjeçar referuar dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Me gjithë problematikat e konstatuara edhe nga auditimi i mëparshëm masat e marra nuk kanë qenë të plota dhe janë përsëritur disa problematika edhe në vitin 2023 si në rastin e subjekteve “D” dhe “E”. Në mbyllje të vitit 2023 rezultojnë 3 subjekte debitore, nga të cilat për 2 subjektet debia është në vlerën 1,200,000 lekë, ndërsa për subjektin “M”, Sektori i Infrastrukturës nuk ka informacion mbi detyrimin, pasi ky

subjekt e ka ushtruar aktivitetin e tij prej disa vitesh i papajisur me licencën përkatëse, si dhe nga ana e tyre nuk ka një analizë për të llogaritur vlerën e detyrimit apo të gjobës që duhet të ngarkohet. Masa e vetme është ajo e bllokimit të llogarive bankare. Problematika e mësipërme me subjektin “M” është konstatuar edhe në auditimin e mëparshëm dhe rezultojnë që gjatë vitit 2023 të mos jetë marrë asnjë masë për ndryshimin e situatës së konstatuar për vitin 2022.

Veprimet dhe mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 2 të nenit 4, pikat i-vi në shkronjën “ç” në nenin 5 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, shkronjat “a” dhe “b” në pikën 1.3 në nenin 9, shkronjën “c” të pikës 5 në nenin 35 të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, pikën 1 të nenit 29, pikën 1 të nenit 69, pikat 1 dhe 2 në nenin 89 të Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, nenin 12 dhe 14 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, pikat 15.1 dhe 15.2 të Kreut II në VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr. 344, datë 19.04.2017. *VKB nr. 117 prot datë 26.11.2022 për miratimin e paketës fiskale për vitin 2023 neni 25.*

### Gjocat e IMTV

Për periudhën objekt auditimi nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Bashkia Mat është njoftuar zyra juridike për vazhdimin e procedurave për arkëtimin e gjobave të vendosura. Nga Inspektorati Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Mat për periudhën objekt auditimi janë vendosur 6 (gjashhtë) gjoba në vlerën 607,540 lekë nga të cilat është arkëtuar vlera 557,540 lekë, për 5 (pesë) gjoba të vendosura. Gjatë viti 2023 është referuar në gjykatë për tu kthyer në titull ekzekutiv 1 (një) gjobë me vlerë principali 50,000 lekë dhe kamatëvonesë në vlerën 11,000 lekë.

Në **aneksin nr.2/11** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit paraqiten të dhënat për gjobat e vendosura nga Sektori i IMTV.

### Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste

Në paketën fiskale të vitit 2020, me VKB u miratua opsioni i lidhjes së marrëveshjes me debitorët për shlyerjen e detyrimit me këste nga ana e tyre. Kjo marrëveshje do të lidhej nga Agjenti Tatimor UK Mat me subjektet/abonentë debitore. Në informacionin e përcjellë nga STTV, rezultojnë se janë lidhur akt marrëveshje, por dokumentet nuk i janë vënë në dispozicion Zyrës Juridike dhe DEA /STTV. Kjo ka sjellë që nga STTV të mos ketë informacion mbi respektimin e kushteve të marrëveshjes nga ana e debitorëve lidhur me pagesën e kështit në afat dhe përfundimin në afat të marrëveshjes, por nga akt rakordimet pasqyrohen vetëm arkëtimet e kryera dhe vlera e detyrimit të mbetur në fund të çdo viti ushtrimor. Nga STTV grupit të auditimit iu vu në dispozicion informacioni i kërkuar në tabelën si më poshtë:

Në **Pasqyrën nr. 11**. Paraqiten të dhëna për subjektet që kanë lidhur akt-marrëveshje për pagesën e taksave dhe tarifave vendore.

GJENDJA NE FUND TE VITIT 2023					
Numri Subjekteve	Vlera Kesti Total	Maturimi	Kredi	Debi 31.12.2023	Numri Subjekte Debitore
<b>38 në Total</b>	<b>158,900</b>	<b>5,536,103</b>	<b>1,243,049</b>	<b>4,293,054</b>	<b>37</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Në **aneksin nr.2/14** bashkëlidhur projekt raportit të auditimit paraqiten të dhënat për akt-marrëveshjet dhe pagesat e kryera.

Nga auditimi dhe informacioni i paraqitur në aneksin nr.2/14 në anekset e projekt raportit të auditimit, rezultojnë se janë 38 subjekte debitore në vlerën debitore të mbetur (maturuar) 5,536,103 lekë, janë paguar gjatë vitit 2023 nga 38 subjektet vlera 1,243,049 lekë dhe 37 subjekte debitore kanë mbyllur vitin 2023 në vlerën totale të debisë 4,293,054 lekë, pasi Subjekti R S ka shlyer detyrimin totalisht në fund të vitit 2023.

## Nga aktiviteti i MZSH:

### Në Pasqyrën nr. 12. Paraqiten të ardhurat nga sektori i MZSH

Llog. ekonomike	Emërtimi	Plan		Fakt	
		2022	2023	2022	2023
7113011	Të ardhura nga shërbimet e MZSH	314,000	320,000	153,000	48,000

**Burimi:** Bashkia Mat

Një përshkrim i detajuar mbi llojin e aktivitetit të MZSH prej nga janë siguruar të ardhurat për buxhetin e Bashkisë Mat për vitin 2023, janë si më poshtë vijon:

1. Ndërhyrje sipas Librit të Zjarreve, Shpëtimit dhe aktiviteteve sportive janë 63 raste.
2. Raport ndërhyrjes i pas rastit të zjarreve janë 63 gjithsej.
3. Çertifikatë për sigurinë nga zjarri janë lëshuar 4 copë.
4. Mandat për sigurinë nga zjarri janë 4 copë. (2 raste x 5,000 lekë janë për herë të parë dhe 2 raste x 2,000 lekë janë Rinovim)
5. Vërtetim rënie zjarri janë lëshuar 8 copë.
6. Mandat pagesë për vërtetim zjarri (4 copë x 1,000 lekë).
7. Miratim projekti 5 copë.
8. Mandat pagesë (4 raste x 5,000 lekë + 1 rast x 3,000 lekë).

### Përfshirjet nga Taksat dhe Tarifat/Kategoritë sociale përfituese

Në Paketën Fiskale 2023, janë parashikuar nga DEA dhe miratuar me VKB nr. 117 datë 25.11.2022 edhe disa kategori sociale për tre lloj taksash: Taksë Ndërtese, Taksë Trualli dhe Taksë tokë bujqësore dhe 1 tarifë – tarifa e pastrimit, të cilat në mënyrë të detajuar pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Nga tarifa e pastrimit përfitojnë në total 1,973 kryefamiljarë të cilët paguajnë vlerën totale prej 1,572,000 lekë në vit ose 1,369,300 lekë më pak se vlera totale pa lehtësira fiskale;

Nga taksa e ndërtesës përfitojnë 624 kryefamiljarë në vlerën totale 811,312 lekë; taksa e truallit me 369 kryefamiljarë përfitues në vlerën 13,483 lekë dhe taksa e tokës bujqësore ka 300 kryefamiljarë përfitues në vlerën prej 102,543 lekë.

Pra në total janë 3,266 raste si përfitues nga taksa e tarifa vendore në vlerën totale vjetore prej 2,499,338 lekë.

STTV ka evidencë vjetore të hartuar mbi vlerën e vjelë të tyre dhe vlerën e plotë të taksave që duhej të arkëtohej në rast se nuk do përfshihej në paketën e lehtësisë fiskale.

### **Komisioni i Apelit Administrativ**

Bashkia Mat ka ngritur Strukturën e Hetimit Tatimor me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 769 datë 11.11.2022 dhe me nr. 4889 prot., datë 11.11.2022 i ndryshuar me Urdhrin nr. 156 datë 20.03.2023 dhe me nr. 1246 prot., datë 20.03.2023 "Për plotësimin e SHT në Bashkinë Mat", në zbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 7 i tij;

KHT, Bashkia Mat funksionon mbështetur në Rregulloren e miratuar me VKB nr. 55 datë 19.07.2018.

KHT për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 është i përbërë si më poshtë vijon:

### Në Pasqyrën nr. 14. Paraqiten të dhëna për Komisioni e Apelit Administrativ

Nr	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional/arsimor
1	E.H	Sekretar i Përgjithshëm	Jurist
2	F.S	Zyra Juridike	Juriste
3	D.N	Zyra e Urbanistikës	Inxhinierë
4	S.B	Apelimi Tatimor	Ekonomist
5	E.Ç ≠S.Ç	Agjent Tatimor	Ekonomist

**Burimi:** Bashkia Mat

Nga auditimi i evidencave të vëna në dispozicion grupit të auditimit, rezulton se gjatë vitit 2023, janë paraqitur pranë Bashkisë Mat 6 ankime nga subjekte të ndryshme, të cilat janë trajtuar nga KHT dhe paraqiten si më poshtë vijon:

Në **Pasqyrën nr. 15**. Paraqiten të dhëna për ankesat e shqyrtuara nga Komisioni e Apelimit Administrativ.

Dosjet që janë paraqitur me ankim administrativ				
Nr	Dosja/Vendimi	Data	Subjekti	Statusi
1	Nr. 01	24.01.2023	Shoqëria A SHPK	√
2	Nr. 10	21.03.2023	Shoqëria O SHPK	Proces Gjyqësor
3	Nr. 11	21.03.2023	Subjekti S SHPK	Proces Gjyqësor
4	Nr. 12	12.05.2023	Subjekti Fizik H.M	√
5	Nr. 13	04.07.2023	Subjekti Fizik L.H	√
6	Nr. 14	04.07.2023	Subjekti Fizik B.D	√

**Burimi:** Bashkia Mat

Për vitin 2023 KHT ka përgatitur Raportin vjetor me objekt "Informacion mbi ankesat nga tatimpaguesit si dhe ata debitorë të cilët janë në proces gjyqësor për mosnjohje të detyrimit, nga struktura vendore e Hetimit Tatimor të Bashkisë Mat për vitin 2023" datë 25.07.2024.

### **Përlllogaritje të gabuara/përjashtim nga taksa e ndërtesës dhe tarifës së shërbimit të disa bizneseve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Mat.**

Në auditimin e ushtroar më parë, grupi i auditimit ka konstatuar disa problematika lidhur me përjashtimin apo përlllogaritje të gabuar të taksës së ndërtesës dhe truallit.

Nga ana e Bashkisë Mat, Struktura juridike, STTV dhe GMS të hartojnë një strategji apo plan masash ku të përcaktohen saktë dhe qartë hapat që duhen ndjekur për zgjidhjen e ngërçit të krijuar, me qëllim pasqyrim të saktë të vlerës debitorë në kontabilitetin e Njesisë publike.

-Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njesisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2, ku përcaktohet se:

“Kryetari i njesisë së vetëqeverisjes vendore merr masa dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore.”

### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

1. Z. A.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues,
2. Z. D.R, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, periudha (01.01.2023-17.03.2023)
3. Zj. D.T, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe të Ardhurave Vendore, periudha (17.03.2023-vijim)
4. Zj. S. Ç me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, periudha (13.09.2023-vijim)
5. Z. A.H me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pyjeve

### **2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**2.3.1.** Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

**2.3.2.** Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njesisë.

**2.3.3.** Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës, arkës dhe magazinës.

**2.3.4.** Verifikimi i inventarëve të Aktiveve Afatgjata Materiale sa prej tyre janë me çertifikatë pronësie.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat Financiare për periudhën ushtrimore raportuese (janar-dhjetor 2023).
- Ditarët e kontabilitetit për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.
- Listë pagesat me përzgjedhje të periudhës raportuese ushtrimore e vitit 2023.
- Dokumentet e bankës dhe të arkës për periudhën raportuese ushtrimore të vitit 2023.
- Akt-rakordimet e kryera me degën e thesarit Mat për periudhën raportuese të vitit 2023.
- Dokumentet e inventarizimit fizik të AAGJM, etj, për periudhën raportuese ushtrimore viti 2023.

#### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:**

- **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2023 Bashkia Mat nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara. Bashkia Mat ka 3(tre) ndërmarrje varësie ,Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Futbollit Burrel dhe Tregu Mat.

Bashkia Mat ka hartuar pasqyrat individuale të aparatit të bashkisë të cilat i ka dorëzuar në degën e thesarit Mat në datë 28.03.2023.

Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkia Mat ka depozituar në degën e thesarit Mat pasqyrat financiare në datë 13.03.2023 të cilat janë miratuar nga dega e thesarit në datë 29.03.2023.

Klubi i Futbollit Burrel ka depozituar në degën e thesarit Mat pasqyrat financiare në datë 29.03.2023 të cilat janë miratuar nga dega e thesarit në datë 29.03.2023.

Tregu Mat ka depozituar në degën e thesarit Mat pasqyrat financiare në datë 22.04.2023.

Bashkia Mat ka vepruar në kundërshtim me ligjin 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 12 pasqyrat financiare të konsoliduara.

Bashkia Mat për hartimin e pasqyrave financiare individuale dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. Lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Mat si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimi.

- **Hartimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Mat.**

Për vitin 2023 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Floë).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

- **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

**Pasqyrat Financiare individuale** të Bashkisë Mat për vitin 2023 janë të nënshkruara nga z. A.M Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. D.T me detyrë Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Mat në datë 28.03.2023, në përputhje me afatet e përcaktuara me ligj.

- **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.**

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhet me veprim ekstra-kontabël.
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentacionit bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- **Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare individuale, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Mat për aktivitetin ekonomiko- financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike; Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 3,731,573,540 lekë dhe për vitin 2023 është 4,374,960,619 lekë.

### **Auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023:**

Në hartimin e bilancit është zgjedhur që nënzërat e bilancit të paraqiten drejtpërdrejtë në pasqyrën e bilancit.

**Pasqyra e pozicionit financiar** të Bashkisë Mat në 31.12.2023, sipas **formatit F1**, është paraqitur më poshtë:

#### **1.Pasqyra e pozicionit financiar (F1).**

- **Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet=4,018,898,026 lekë.**

- Aktivet 4,374,960,619 lekë
- Detyrimet 356,062,593 lekë
- Aktivet Neto 4,018,898,026 lekë

#### **Aktivet afatshkurtra:**

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2023 paraqiten në vlerën **482,422,857 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 206,147,338 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 48,765,276 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 227,510,243 lekë

#### **Fondi i Konsoliduar:**

##### **Llogaria 101 “Teprica (Fondi I akumuluar/Deficit i akumuluar)**

Në llogarinë 101 është paraqitur në vlerën 3,941,303,038 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF1:** Detajet e nënrubrikës ‘Teprica’.

Zërat për të cilat pakësohet fondi	Llogaria 101		Zërat për të cilat shtohet fondi
	Debi	Kredi	
Nxjerrje jashtë përdorimit	73,849,667	3,257,823,616	Çelje
Amortizim i vitit	84,925,219	284,726,663	Investime + Dhurime
		(7,427,632)	Ndryshim i gjendjes së inventarit
	158,774,886	3,549,997,911	
<b>Shuma</b>		<b>3,391,203,025</b>	

**Burimi:** Bashkia Mat

Sipas analizës në tabelën e mësipërme e vlera e raportuar në bilanc është mbivlerësuar në vlerën 550,100,013 lekë në kundërshtim me udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

#### **Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:**

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 206,147,338 lekë, përbëhet nga gjendja e llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në shumën 77,594,988 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 128,552,350 lekë.

Lëvizjet e klasës 5“Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre”, paraqitet në **aneksin nr. 2/3/1** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 206,147,338 lekë kuadron me llogaritë 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" dhe 466 "Mjete në ruajtje".

Fondet e papërdorura për vitin 2023 janë si më poshtë:

1-Trasferte të pakushtëzuar dhe specifike viti 2023 e papërdorur 51,603,361 lekë.

2-Të ardhurat viti 2023 të papërdorura 25,991,626 lekë.

Totali i fondeve të papërdorura është në shumën 77,594,988 lekë, fonde të cilat do të trashëgohen për vitin 2023.

### **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat në datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 48,765,276 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 16,090,378 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 32,674,898 lekë.

Lëvizjet e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, paraqitet në **aneksin nr. 2/3/2** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Nga verifikimi me zgjedhje sipas ditarit të bankës u verifikuan disa shpenzime për të cilat u kërkua dokumentacion justifikues nga magazina për hyrjet dhe daljet e këtyre mallrave.

Sipas dokumentacionit të vendosur në dispozicion për të gjitha shpenzimet e mëposhtme disponohet dokumentacioni i mëposhtëm:

-Urdhër furnizim hyrje (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë hyrje në magazinë

-Urdhër furnizim shpërndarje sipas kërkesave (e firmosur nga përgjegjësi i financës)

-Fletë dalje nga magazine.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën =-7,427,632 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 7,427,632 lekë.

**Llogaria 312 “Materiale”,** është pasqyruar për vlerën 16,090,378 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Pasqyra PF2:** Detajet e nënrubrikës 312 ‘Materiale’.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	9,243,162
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	62,709,507
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	55,862,291
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>	<b>16,090,378</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

Gjendja e llogarisë 312 “Materiale” në datë 31.12.2023 e pasqyruar në vlerën 16,090,378 lekë është e përbërë nga gjendja e magazinave si mëposhtë.

-Magazina ushqimore në vlerën 1,631,716 lekë:

-Magazina materiale në vlerën 607,702 lekë,

-Magazina e sektorit të rrugëve në vlerën 13,850,944 lekë.

**Llogaria 327 “Objekte inventari”,** ka vlerën 38,674,898 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Pasqyra PF3:** Detajet e nënrubrikës 327 ‘Inventar’.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2023	32,094,482
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2023	2,148,935
Dalje nga magazina gjatë vitit 2023	1,568,519
<b>Gjendja në 31.12.2023</b>	<b>32,674,898</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.11.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Mat ka nxjerrë Urdhrat e inventarizimit ku është përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve. Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

### **Inventarizimi i aktiveve:**

Gjatë vitit 2023, mbështetur dhe në udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” nga ana e Titullarit të Bashkisë Mat është konceptuar dhe firmosur urdhri nr.575 datë 04.10.2023 për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023 të Bashkisë Mat.

Me urdhër nr.576, datë 04.10.2023 të Titullarit të Institucionit është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve për vitin 2023.

Me urdhër nr.574, datë 04.10.2023 të Titullarit të Institucionit është ngritur komisioni i asgjesimit të aktiveve për vitin 2023.

Komisioni për asgjesimin e aktiveve është i përbërë nga punonjës të ndryshëm në përputhje me udhëzimin Nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”.

Komisioni i Inventarizimit me shkresën nr.5273 prot, datë 30.10.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit për aktivet e aparatit të Bashkisë, çerdhet, kopshtet, shkollat, konvikti, kultura dhe magazina. Sipas procesverbalit komisioni ka konstatuar aktive me vlerë kontabël 1,066,931 lekë të cilat janë fizikisht por të amortizuara dhe gjendje inventari qarkullues me vlerë kontabël 188,752 lekë. Aktivet dhe inventari qarkullues të aparatit të Bashkisë Mat të cilat janë amortizuara janë paraqitur në **aneksin nr. 2/3/3** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Komisioni i Inventarizimit me shkresën nr.5273/3 prot, datë 30.10.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit për aktivet e njësive administrative Koms, Baz dhe Ulëz. Sipas procesverbalit komisioni ka konstatuar aktive me vlerë kontabël 695,491 lekë të cilat janë fizikisht por të amortizuara dhe gjendje inventari qarkullues me vlerë kontabël 147,837 lekë. Aktivet dhe inventari qarkullues të Njësive Administrative Koms, Baz dhe Ulëz të Bashkisë Mat të cilat janë amortizuara janë paraqitur në **aneksin nr. 2/3/4** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

Komisioni i Inventarizimit me shkresën nr.5273/2 prot, datë 30.10.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit për aktivet e njësive administrative Lis, Derjan, Macukull dhe Rukaj. Sipas procesverbalit komisioni ka konstatuar aktive me vlerë kontabël 863,310 lekë të cilat janë fizikisht por të amortizuara dhe gjendje inventari qarkullues me vlerë kontabël 14,410 lekë. Aktivet dhe inventari qarkullues të Njësive Administrative Lis, Derjan dhe Macukull të Bashkisë Mat të cilat janë amortizuara janë paraqitur në **aneksin nr. 2/3/5** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

### **Vlerësimi i Aktiveve**

Komisioni i Vlerësimit me shkresën nr.5274/3 prot, datë 24.11.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit për aktivet e aparatit të Bashkisë, çerdhet, kopshtet, shkollat, konvikti, kultura dhe magazina. Sipas procesverbalit komisioni vlerëson të kryhet procedura e asgjesimit për materialet të cilat janë amortizuar.

Në tabelën e mëposhtme gjendet informacioni në sasi dhe vlerë për aktivet të cilat janë propozuar për tu asgjësuar.

**Pasqyra PF4:** Aktive të propozuara për tu asgjësuar Aparati i Bashkisë Mat

Nr	Llogaria	Vlera Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	218	872,386	1,556	1,556	872,386
2	327	386,152	88	88	386,152
<b>Totali</b>		<b>1,255,538</b>	<b>1,644</b>	<b>1,644</b>	<b>1,255,538</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

Komisioni i Vlerësimit me shkresën nr.5274/2 prot, datë 24.11.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit për aktivet e njësive administrative Koms, Baz dhe Ulëz. Sipas procesverbalit komisioni vlerëson të kryhet procedura e asgjesimit për materialet të cilat janë amortizuar.

Në tabelën e mëposhtme gjendet informacioni në sasi dhe vlerë për aktivet të cilat janë propozuar për tu asgjësuar.

**Pasqyra PF5: Aktive të propozuara për tu asgjësuar Njësitë Administrative.**

Nr	Llogaria	Vlera Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	218	695,491	143	143	695,491
2	327	147,837	96	96	147,837
<b>Totali</b>		<b>843,328</b>	<b>239</b>	<b>239</b>	<b>843,328</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

Komisioni i Vlerësimit me shkresën nr.5274/2 prot, datë 24.11.2023 ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit për aktivet e njërive administrative Lis, Derjan, Macukull dhe Rrukaj. Sipas procesverbalit komisioni vlerëson të kryhet procedura e asgjësimit për materialet të cilat janë amortizuar.

Në tabelën e mëposhtme gjendet informacioni në sasi dhe vlerë për aktivet të cilat janë propozuar për tu asgjësuar.

**Pasqyra PF6: Aktive të propozuara për tu asgjësuar Njësitë Administrative**

Nr	Llogaria	Vlera Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	218	863,310	214	214	863,310
2	327	14,410	13	13	14,410
<b>Totali</b>		<b>877,720</b>	<b>227</b>	<b>227</b>	<b>877,720</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

**Komisionet e Asgjësimit:**

Komisioni i Asgjësimit Fizik të Aktiveve i ngritur me urdhër të Titullarit të Institucionit nr.574, datë 04.10.2023 ka hartuar relacionin mbi asgjësimin fizik për vitin 2023 për aparatën e Bashkisë Mat, Kopshtet, Çerdhet, Qendrën Kulturore të fëmijëve, Pallatin e Kulturës, Shkollat, Zjarrfikësen, Magazinat në njësitë Burrel dhe Njësitë Administrative.

Në tabelën e mëposhtme gjendet informacioni në sasi dhe vlerë për aktivet të cilat janë propozuar për tu asgjësuar.

**Pasqyra PF7: Aktive për tu asgjësuar Bashkia Mat dhe Njësitë Administrative**

Nr	Llogaria	Vlera Kontabël	Sasi Kontabël	Sasi fizike	Vlera
1	218	2,252,401	1,877	1,877	2,252,401
2	327	224,369	137	137	224,369
<b>Totali</b>		<b>2,476,770</b>	<b>2,014</b>	<b>2,014</b>	<b>2,476,770</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

**Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme ”&“Të tjera aktive afatshkurtra”:**

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr.2/3/6** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, gjendje e cila në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 74,355,304 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 71,947,410 lekë, kjo llogari gjatë vitit 2023 ka ulje me vlerë 2,407,894 lekë. Vlerë e cila i përket debitorëve për taksa e tarifa vendore për bizneset dhe taksa e tarifa vendore familjarët, sipas akt akordimit midis Sektorit të Taksave dhe Drejtorisë Ekonomike. Nga analiza e llogarisë 468 “**Debitorë të ndryshëm**” konstatohet se Drejtoria e Financës nuk ka bërë kontabilizimin e detyrimeve të abonentëve familjarë për tarifatat vendore (pastrim, gjelbërim, ndriçim) dhe taksën bujqësorë dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 50,486,470 lekë. Me shkresën me Nr.1105 prot, Drejtoria Juridike dhe Taksave Vendore ka dërguar në Drejtorinë Ekonomike dhe të të Ardhurave listën e debitorëve deri në datën 31.12.2023 pa përfshirë debitorët familjarë. Sipas llogarisë analitikë 468 “Debitorë të ndryshëm” në krahasim me shkresën përcjellëse nga sektori i taksave vendore kemi diferenca të debitorëve si mëposhtë:

**Pasqyra PF8: Analiza e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”**

Lloji i taksës	Llogaria 468	Informacioni nga sektori i taksave vendore	Diferenca
Biznes Vip	5,467,793	3,623,833	1,843,960
Biz i madh	24,033,745	18,714,937	5,318,808
Biz i vogël	26,946,622	15,728,075	11,218,547

Lojra Fati	955,507	722,515	232,992
Institucione	2,661,500	2,205,000	456,500
Gjoha	9,596,344	-	9,596,344
<b>Shuma</b>	<b>71,947,410</b>	<b>40,994,360</b>	<b>30,953,050</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

**Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 137,788,310 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila është paraqitur në vlerën 137,788,310 lekë. Vlera prej 137,788,310 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF9:** Detajet e nënrubrikës “Të tjera operacione me shtetin”.

<b>Emërtimi i llogarive</b>	<b>Vlera</b>
Llogari 401-408	113,938,260
Paga personeli llog 42	17,151,786
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	902,590
Sigurime shoqërore llog.435	5,095,579
Sigurime shëndetësore llog.436	700,095
<b>Totali</b>	<b>137,788,310</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Nga analiza e mësipërme llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” është paraqitur saktë dhe kuadron me llogaritë e klasës 4.

### **Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”**, përbëhen nga llog.202 “Studime dhe Kërkime”, dhe paraqiten me kosto historike 43,519,066 lekë, amortizim të akumuluar në vlerën 3,510,797 lekë, shtesa gjatë vitit 2023 në vlerën 95,000 lekë dhe vlerë neto 40,103,269 lekë. Nga auditimi i llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” rezulton se projektet e regjistruara në këtë llogari nuk janë vendosur në zbatim. Gjatë vitit 2023 ka patur shtesë për projektin “Ura fshati German” me vlerë 95,000 lekë.

### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21 “Aktivet Afatgjata Materiale”**, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2023, paraqiten me tepricë neto 1,816,946,094 lekë. Në vitin paraardhës 2022, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 1,691,089,317 lekë. Gjatë viti 2023 kemi patur shtesë të AAM-ve 284,726,663 lekë, shtesat kanë ardhur kryesisht si rezultat i investimeve të ndryshme në ndërtesa, rrugë, rrjete, vepra ujore dhe blerje, në Bashkinë Mat dhe NJ.A Administrative.

Pakësimet nga amortizimit gjatë vitit 2023 kanë qenë në vlerën 84,925,219 lekë dhe pakësime nga nxjerrje jashtë përdorimi në vlerën historike 2,252,401 lekë dhe pakësime të aktiveve të cilat janë transferuar në ndërmarrjet e tjera në varësi të Bashkisë Mat janë në vlerën historike 126,155,497 lekë. Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF11:** Detajet e nënrubrikës “Aktive afatgjata materiale”.

<b>Nr Llog</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Teprica neto në 31.12.2022</b>	<b>Shtesa 2023</b>	<b>Amortizim 2023</b>	<b>Pakësime 2023</b>	<b>Gjendja me 31.12.2023</b>
210	Toka, Troje, Terrene	28,625,929	-	-	-	28,625,929
211	Pyje, Kullota, Plantacione	10,550,203	-	-	-	10,550,203
212	Ndërtime e Konstruksione	758,603,832	251,167,788	37,495,396	43,446,046	928,830,178

213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	830,304,982	1,566,879	41,515,249	-	790,356,612
214	Instalime dhe paisje	8,985,129	1,374,600	449,256	2,857,627	7,052,846
215	Mjete Transporti	38,559,609	-	2,373,392	26,027,048	10,159,169
218	Inventar Ekonomik	15,459,633	-	3,091,926	1,518,946	41,371,157
	<b>Shuma</b>	<b>1,691,089,317</b>	<b>284,631,663</b>	<b>84,925,219</b>	<b>73,849,667</b>	<b>1,816,946,094</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

**1. Llogaria 210 “Toka, troje terrene”** është paraqitur në bilanc me kosto historike 28,625,929 lekë. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur ndryshime në llogarinë 210 “Toka, troje terrene” si mëposhtë: Referuar objekteve të regjistruara në llogarinë 210 “Toka, troje, terrene” rezultojnë 5 (pesë) aktive të regjistruara në kundërshtim me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël të cilat i përkasin llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

-Rregullim Lulishte shkolla Shlli me kosto historike 152,000 lekë.

-Shkolla 9-vjeçare "M.Gjestila" me kosto historike 1,024,598 lekë.

-Shkolla 9-vjeçare, "31-Korriku" me kosto historike 1,024,599 lekë.

-Sporti me kosto historike 17,258,985 lekë.

- Këndi i lojrave me kosto historike 3,482,161 lekë.

Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik dhe gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM i janë transferuar Bashkisë Mat dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pika 26.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF12:** Detajet e nën rubrikës “Toka, troje, terrene”.

Llog	Emërtimi	Kosto Historike	Vlera Neto
210	Rregullim Lulishtje shkolla Shlli	152,000	152,000
210	Shk.9-vjeç, "M.Gjestila"	1,024,598	1,024,598
210	Shk.9-vjeç, "31-Korriku"	1,024,599	1,024,599
210	Sporti	17,258,985	17,258,985
210	Këndi I lojrave	3,482,161	3,482,161
210	Toke per Varrezat	4,532,186	4,532,186
210	Shpronësim per varreza	1,151,400	1,151,400
	<b>Shuma</b>	<b>28,625,929</b>	<b>28,625,929</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

## 2. Llogaria 211 “Pyje, Kullota, Plantacione”

Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2022 me vlerë 10,550,203 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 10,550,203 lekë. Kjo llogari nuk ka inventar kontabël dhe inventar fizik dhe gjithashtu në vlerën e saj nuk janë përfshirë vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Mat dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pika 26.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF13:** Detajet e nën rubrikës “Pyje, Kullota, Plantacione”.

Nr	Objekti	211
1	Nj ad Macukull(Total)	8,071,531
	Pyllëzim me arroje	8,071,531
2	Nj ad Rukaj( Total)	1,365,712
	Pyje e kullota	1,365,712
3	NJ Ad Baz(Total)	1,112,960
	Sistemim gjelbërim	1,112,860
	<b>Totali</b>	<b>10,550,203</b>

**Burimi:**Bashkia Mat

**3. Llogaria 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** cila pasqyron gjendjen e 109 aseteve për llogari të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerë neto kontabël 758,603,832 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa Konstruksione” përbëhet prej 109 aseteve me vlerë kontabël neto 928,830,178 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 212“Ndërtesa Konstruksione” është pakësuar nga transferimi i 2 (dy) aktiveve me vlerë historike 62,529,775 lekë dhe vlerë amortizimi 22,567,613 lekë.

**Pasqyra PF14: Aktive të transferuara:**

Nr	Llog	Emërtimi	Vl. Kontabël	Amortizim i Akumuluar	Vlera neto 2023
1	212	Ndërtesa Agjencia e rrugëve	174,036	66,298	107,738
2	212	Tregu Mat	67,357,533	24,019,225	43,338,308
<b>Shuma</b>			<b>67,531,569</b>	<b>24,085,523</b>	<b>43,446,046</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

Për aktivin “Tregu Agro-Ushqimorë” në bazë të shkresës nr. 1693 prot, datë 19.04.2022 është kryer vlerësimi i pasurisë nr 948/ND lloji i pasurisë ndërtesë. Në bazë të vlerësimit nga vlerësuesi i pavarur ky aktiv është vlerësuar për vlerën 30,211,950 lekë.

Në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023 ky aktiv është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar i pa rivlerësuar në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

f) Për përcaktimet e aktiveve afatgjata, në përdorim tek institucione të varësisë ose të tjerë, funksionimi i vlerës historike dhe amortizimit (vlerë neto) është si më poshtë:

Në institucionin që cakton:

- Kreditohen 20, 21 (analizat shtatëshifrore përkatëse);
- Debitohet 28 “ Caktime të aktiveve afatgjata”.

Amortizimi për vitin 2023 i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione është në vlerën 41,515,249 lekë. Gjatë vitit 2023 nga investime e kryera nga Bashkia Mat janë kryer kontabilizimet për 9 (nëntë) objekte në llogarinë 212 “Ndërtime dhe Konstruksione”.

**Pasqyra PF15: Shtesa të aktiveve gjatë vitit 2023:**

Nr	Llog	Emërtimi	VKN 31.12.2022	Shtesa gjatë vitit 2023	Amortizim 2023	Vlera neto 2023
1	212	Shkolla 9 vjeçare M.gjestila	2,042,046	106,420,725	102,102	108,360,669
2	212	Shkolla e mesme “28 nëntori”	2,501,750	99,997,515	125,087	102,374,177
3	212	Kopshti Nr.2	498,104	551,247	24,905	1,024,446
4	212	Konvikti Burrel	34,626,014	1,840,664	1,731,301	34,735,377
5	212	Ish shtëpia e ushtarakëve Burrel	-	481,777	-	481,777
6	212	Rikonstruksion solete dhe kafazi i pallatit	-	492,612	-	492,612
7	212	Aneksi i stadiumit	-	41,099,223	-	41,099,223
8	212	Godinë Sociale	12,882,249	81,879	214,704	12,749,424
9	212	Qendra shëndetsore Lis	7,224,361	202,146	361,218	7,065,289
<b>Shuma</b>			<b>59,774,524</b>	<b>251,167,788</b>	<b>2,559,317</b>	<b>303,382,994</b>

**Burimi:** Përpunoi Grupi i Auditimit

Analiza e llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF16: Detajet e nënrubrikës “Ndërtesa Konstruksione”.**

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
1,135,476,105	376,872,273	251,167,788	43,446,046	37,495,396	1,319,112,324

**Burimi:** Bashkia Mat

**4. Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** cila pasqyron gjendjen e 156 aseteve për llogari të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2022 rezulton me vlerë neto kontabël 830,304,982 lekë. Gjatë vitit 2023 llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” përbëhet prej 157 aseteve me vlerë kontabël neto 790,356,612 lekë.

Gjatë vitit 2023 llogaria 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” është shtuar për investimin “Rikonstruksion vepra e marrjes Kanali Muzhake” me vlerë 1,566,879 lekë.

Amortizimi për vitin 2023 i llogarisë 213 është në vlerën 189,610,181 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën** më poshtë.

**Pasqyra PF17:** Detajet e nënrubrikës “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
1,320,536,379	490,231,397	1,556,879	-	41,515,249	1,322,103,258

**Burimi:** Bashkia Mat

**5. Llogaria kontabël 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune”.** Kjo llogari përfaqëson makineri paisje dhe vegla pune në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Mat. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mat gjendja e llogarisë 214 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 7,052,846 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 214 “Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune” është ulur me vlerën 1,932,283 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,374,600 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 449,256 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit janë në vlerën neto 2,857,627 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF** më poshtë.

**Pasqyra PF18:** Detajet e nënrubrikës “*Instalime teknike, makineri, paisje vegla pune*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
16,435,311	7,450,182	1,374,600	2,857,627	449,256	12,489,872

**Burimi:** Bashkia Mat

**6. Llogaria 215 “Mjete transporti”.** Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Mat më datë 31.12.2023 me vlerë neto kontabël 10,159,169 lekë e cila përbëhet prej 17 mjedesh.

Gjatë vitit 2023 kjo llogari nuk ka pasur shtesa mjedesh. Llogaria është pakësuar nga amortizimi vjetor në vlerën 2,373,392 lekë dhe janë transferuar në Ndërmarrjen e Pastrimit, 23 mjete me vlerë historike 51,779,399 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 25,752,351 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF** më poshtë.

**Pasqyra PF19:** Detajet e nënrubrikës “*Mjete Transporti*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
88,378,853	49,819,244	-	26,027,048	2,373,392	36,599,454

**Burimi:** Bashkia Mat

**7. Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”.** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Mat. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mat gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet me vlerën kontabël neto 15,459,633 lekë. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 218 “Inventar ekonomik” është rritur me vlerën 25,911,524 lekë. Gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pasur shtesa në vlerën 30,522,396 lekë. Amortizimi i vitit 2023 është në vlerën 3,091,926 lekë. Pakësimet nga nxjerrja jashtë përdorimit janë në vlerën 3,776,891 leke,

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **Pasqyrën PF** më poshtë.

**Pasqyra PF20:** Detajet e nënrubrikës “*Inventar Ekonomik*”.

Kosto Historike 31.12.2022	Amortizim i Akumuluar	Shtesa 2023	Pakësime neto 2023	Amortizim 2023	Kosto historike 31.12.2023
115,884,984	100,425,351	30,522,396	1,518,946	3,091,926	142,630,489

**Burimi:** Bashkia Mat

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mat në fund të vitit 2023, paraqitet në vlerën (1,058,676,232) lekë që ka të bëjë me

amortizimin e akumuluar me datë 31.12.2023. Krahasuar me vitin 2022 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (30,366,988) lekë, shtesë e cila ka të bëjë me amortizimin vjetor të vitit 2023.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në **aneksin nr. 2/3/6** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

### **Testi substancial i amortizimit**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr. 05 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Mat, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

### **Aktivitet Afatgjata Financiare**

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2023 në vlerën 31,697,950 lekë. Kjo vlerë e regjistruar në pasqyrën e pozicionit financiar i përket kuotave të Bashkisë Mat.

-Bashkia Mat, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të “KF Burreli” sh.p.k me NUIS“L.....K” e cila është shoqëri aksionare me objekt, “Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit. Krijimi i ekipeve zinxhir për sportin e futbollit si dhe pjesëmarrja në garat sportive të organizuara nga Federata Shqiptare e Futbollit”. Numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale 1,000 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 100,000 lekë.

-Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 100% të aksioneve të “Tregu Mat” sh.a me NUIS“M.....G” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Projektim, ndërtim, rindërtim, zbatim, të tregjeve me qëllim tregtimin e produkteve bujqësore ose tregjeve të kafshëve”. Numri i aksioneve është 1,000 me vlerë nominale 30,211 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 30,211,950 lekë.

-Bashkia Mat në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si aksionare me 13.86% të aksioneve të “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Dibër” sh.a me NUIS“M.....L” e cila është shoqëri aksionere me objekt, “Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit(eve) të 21 furnizimit të ujit të pijshëm. Prodhimi dhe blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve”. Numri i aksioneve është 13,860 me vlerë nominale 100 lekë/aksion dhe kapital në vlerë monetare prej 1,386,000 lekë.

Vlera e mësipërme sipas Qendrës Kombëtare të Biznesit paraqiten në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2023, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”.

### **Investimet:**

Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 2,003,790,449 lekë.

Llogaria llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” përbëhet nga 16 investime në proces të cilat i përkasin viteve 2020-2023. Gjatë vitit 2023 kemi pasur shtesa në llogari shumën 599,317,254 lekë dhe pakësim për 4 projekte investimi në shumën 80,915,191 lekë të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

Shuma e pakësimeve nuk pasqyron gjendjen reale të aktivitetit sepse shtesat e aktivitetit afatgjatë material gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” për aktivet “Shkolla 28

Nëntori” është debituar për vlerën 99,997,515 lekë , “Shkolla Mustafa Gjestila” në vlerën 106,420,725 lekë dhe “Aneksi i Stadiumit” në vlerën 41,099,223 lekë. Kontabilizimet në llogarinë 231 “Investime” janë kryer në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për përgatitjen, paraqitjen e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

**Pasqyra PF21: Analiza e llogarisë 231 “Investime”**

Emërtimi	Vlera e mbetur 31.12.2022	Shtesa 2023	Pakësime 2023	Vlera e mbetur 31.12.2023
Shkolla 28 nëntori	35,142,123		35,142,123	-
Shkolla Mustafa Gjestila	22,004,816		22,004,816	-
Shkolla e mesme Pjeter Budi	-	39,753,763		39,753,763
Ndërtim Ujësllësi Derjan Rukaj Loti I	456,694,663	127,485,766		584,180,429
Ndërtim Ujësllësi Derjan Rukaj Loti II	221,477,607	78,400,000		299,877,607
Ujësllësi Burrel faza I&II	726,259,965	282,506,045		1,008,766,010
Bashkëfinancim Ujësllësi German	1,000,000	3,225,009		4,225,009
Ndërtim rruga Varrezat e qytetit - Bater e vogel		6,360,000		6,360,000
Rikonstruksion rruga Qamil Xhika		3,360,000		3,360,000
Rikualifikim Urban Blloku Lagja e re		6,630,000		6,630,000
Rikonstruksion rruga Lis		6,555,300		6,555,300
Rikonstruksion i rrugës dhe sheshit varrezat e dëshmoreve		4,211,280		4,211,280
Rikonstruksion ish Hoteli uzinës		18,670,589		18,670,589
Rikonstruksion pallati kulturës Shefqet Doda		3,176,795		3,176,795
Rikonstruksion Tregu I Qytetit		2,040,000		2,040,000
Përshtatje e tregut Frigoriferik		9,481,936		9,481,936
Rikonstruksion Ura pasarele Rrethe Baz		6,501,731		6,501,731
Gabinë informacioni infopoint		959,040	959,040	-
Aneksi I stadiumit	22,809,212		22,809,212	-
<b>Shuma</b>	<b>1,485,388,386</b>	<b>599,317,254</b>	<b>80,915,191</b>	<b>2,003,790,449</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Mat më datë 31.12.2023, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2023, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

**Pasqyra PF22: Detajet e nënrubrikës “Llogari të pagueshme”.**

Llogaritë	Viti 2023	Viti 2022	Diferenca
401-408 Furnitorë e llogari të lidhura me to	113,938,260	217,797,446	(103,859,186)
42 Detyrime ndaj personelit	17,151,786	16,979,740	172,046
431 Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	902,590	759,919	142,671
435 Sigurime shoqërore	5,095,579	4,978,327	117,252
436 Sigurime shëndetësore	700,095	684,318	15,777
467 Kreditor të ndryshëm	0	0	0

**Burimi:** Bashkia Mat

**Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”,** në fund të vitit 2023 është paraqitur në vlerën 113,938,260 lekë dhe paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Mat më datë 31.12.2023. Fatura taimore ë cila i përkasin muajt nëntor dhe dhjetor 2023 janë 55 fatura tatimore me vlerë detyrimi 28,811,469 lekë. Analiza e këtyre faturave është paraqitur në **aneksi nr. 2/3/9** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit..

Faturat tatimore për të cilat ka kaluar afati 60 ditor i pagesës janë në vlerën 85,126,791 lekë, nga këto kemi 7 fatura tatimore më vlerë 56,104,832 lekë për të cilat janë parashikuar në kontratat e sipërmarrjeve afati i pagesës në vitin 2024. Analiza e këtyre faturave është paraqitur në **aneksi nr. 2/3/8** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit.

**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”,** sipas pasqyrave financiare të konsoliduara të Bashkisë Mat, paraqitet në vlerën 17,151,786 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u

paguar në muajin janar të vitit pasardhës, dhe janë paguar në muajin janar 2024 në vlerën 17,151,786 lekë.

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 902,590 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor është paguar në janar 2024 në vlerën 902,590 lekë.

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 5,095,579 lekë dhe 700,095 lekë.

**Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”**, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mat, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 128,552,350 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Mat.

Nga analiza e llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje”, konstatohet se në këtë llogari vazhdojnë të jenë të ngurtësuara fonde në vlerën 9,151,351 lekë për të cilat ka kaluar afati i garancisë. Në **aneksin nr. 2/3/10** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit gjenden garancitë e ngurtësuara në llogarinë 466” Kreditore për mjete në ruajtje” të cilat duhet të çregjistrohen nga kjo llogari.

Sistemimi i vlerës totale të llogarisë 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” duhet të bëhet duke njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të sistemuar dhe pastruar garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mos respektim të kërkesave të UMF nr. 8, datë 9.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*”, Kap. III, pikat 30, 50, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “*Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit*” i ndryshuar, Kap. II, pika 10.

### **Pasqyra e Performancës Financiare:**

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në **aneksin nr. 2/3/11** anekset e raportit përfundimtar të auditimit.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 860,380,822 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Mat paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 78,069,510 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 282,388 lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 13,766,605 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 64,020,517 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 11,996,642 lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura të tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 1,814,550 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë 711 “*Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare*” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 10,182,393 lekë, e cila përfshin tarifën e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 782,785,834 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 “*Paga, shpërblime e të tjera personeli*” për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 266,214,511 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 266,214,511 lekë diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë 601 “*Kontribute për sigurime*” për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 44,310,931 lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 44,310,931 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë 602 “*Blerje mallra e shërbime*” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 89,275,408 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 89,275,408 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë 606 “*Transferime për Buxhetet familjare e Individë*” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 365,754,964 lekë, dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin.

**Për vitin 2023** totali i te ardhurave në vlerë është 860,380,822 lekë dhe totali shpenzimeve është 782,785,834 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 77,594,988 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatin e ushtrimit”.

**Mbi zbatimin e dispozitave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës (Paga dhe shpërblime etj. për Bashkinë Mat).**

**-Testimi i llogarisë 600 “Pagat dhe shpërblime”**

**Për vitin 2023** numri i punonjësve është miratuar me VKB Nr.62 datë 23.12.2022. Miratuar në total numri 519 punonjës.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Mat, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara. Sipas listë pagesave të muajve janar dhe dhjetor 2023 konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Listë pagesat janë të firmosura nga Drejtori i Financës znj. D.T dhe nga specialistet e pagave. Është përgatitur përmbledhësja e listë pagesave e cila është e firmosur nga Drejtori i Financës dhe nga Kryetari Bashkisë. Janë mbajtur listë prezencat dhe janë të firmosura nga Përgjegjëse i Burimeve Njerëzore z. G.P.

**Hartimi i listë pagesave mbi bazën e listë prezencave të nënshkruara nga përpiluesi, për vitin 2023.**

Me përzgjedhje u audituan listë pagesat e periudhës (Janar dhe Dhjetor 2023) dhe konstatohet se ato plotësohen sipas rregullave të përcaktuara të cilat janë plotësuar mbi bazën e listë prezencave mujore. Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore është hartuar përmbledhësja në përputhje me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës”, i ndryshuar.

Ndalesat për tatimin mbi të ardhurat personale dhe kontributit të sigurimeve shoqërore të punonjësve të Bashkisë Mat, janë në përputhshmëri me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.11.2008 “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ndryshime dhe ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”.

-Referuar kërkesave të VKM nr. 177 datë 08.03.2017, struktura e Bashkisë Mat, është miratuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë të sipërcituara.

Sipas listë pagesave të muajve (Janar dhe Dhjetor 2023)konstatohet se është zbatuar struktura sipas vendimeve miratues.

Tabela e burimit të Financimit të pagave paraqitet në **Pasqyrën PF23** më poshtë:

000/lekë

Periudha	Plan	Fakt	%	Burimi i financimit			
				Trans. e Pakush.	Të ardhura	Trans. e Kushtëzuar	Transferte specifike
Viti 2023	309,096	307,737	99.5	113,910	52,022	6,538	136,136

**Burimi:** Bashkia Mat

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:**

1. Z. A.M, me detyrë Kryetar i Bashkisë, në cilësinë e nëpunësit autorizues,
2. Znj. D.T Drejtor i Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues.

**2.4. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM.**

2.4.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

2.4.2. Auditim mbi procedurat e dhënies me qira të tyre dhe likuidimi i detyrimeve për kontratat e lidhura.

Për trajtimin e kësaj çështjeje, nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

-Listat e inventarëve sipas VKM- ve përkatëse;

-Gjendjen e inventarit të pasurive të paluajtshme dhe regjistrimin e tyre në Drejtorinë Vendore të DVASHK-së Mat;

-Listat e inventarit të pa regjistruar pranë kadastrës Mat

**Auditim mbi administrimin e asetëve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës**

Drejtorja e Mbrojtjes Civile dhe Pronave është pjesë e strukturës të Bashkisë Mat ku me VKB nr. 28, datë 25.08.2023, është miratuar numri i përgjithshëm i punonjësve, ku me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, ka dalë organigrama ku pjesë e strukturës së saj është dhe Specialisti i Pronave në varësi të shefit të Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave, varësi e cila është dhe aktualisht. Ky pozicion nga muaji Dhjetor 2023 ka qenë vakant, vend i cili është plotësuar më datë 24.07.2024. Në rregulloren e brendshme të administratës së bashkisë e miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.717 Prot., datë 24.11.2016 funksionale për vitin 2023, në nenin 58 dhe 59 përcaktohen detyrat përgjegjësitë për dokumentimin dhe përditësimin e të dhënave për asetet e Bashkisë Mat, mbikëqyrin gjithë procesin e inventarizimit në bazë të urdhrat të titullarit dhe arshivojnë gjithë inventarët, sigurojnë dokumentimin, inventarizimin dhe ruajtjen e mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit përkatës financiar kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të inventarit kontabël të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese, përpilojnë fletët e inventarit të aktiveve të qëndrueshme sipas zyrave në Bashki, institucioneve të arsimit, çerdheve, gjendjes civile, ndriçimit rrugor dhe mbajnë kartelat për aktivet e qëndrueshme dhe inventarin e imët. Bashkia Mat, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Mat i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrirja e ish-komunave, aktualisht Njësi Administrative të Bashkisë Mat. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Mat duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrimit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia.

a. Në lidhje me listat e pronave të paluajtshme të Aparatit të Bashkisë Mat dhe Njësive Administrative Burrel, Koms, Ulëz, Baz, Derjan-Rukaj gjatë vitit 2023 është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve për të cilën janë vlerësuar vetëm aktive të cilat janë kontabilizuar në pasqyrat financiare për aktivet të cilat janë transferuar në Bashkinë Mat dhe Njësitë Administrative Lis dhe Macukull nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të këtyre pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me dokumentacion pronësie. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Mat. Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Mat, në mënyrë të përgjithshme përcaktohen detyrat për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve, për inventarizimin e pronave, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve dhe më pas regjistrimin në kadastrë.

b. Nga auditimi i llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione”, 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, 214 “Instalime teknike, makineri pajisje vegla pune”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” konstatohet se nga Bashkia Mat disponohet një regjistër kontabël në formatin Excel, sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, konkretisht në të evidentohet datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia. Nuk është përmbushur detyrimi ligjor për krijimin e një regjistri fizik në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30 si dhe pronat e transferuara me VKM-të për llogaritë 210,211,212 dhe 213 nuk janë të evidentuara në regjistrat të cilat Bashkia Mat i mban në programin Excel.

Asetet e transferuara në pronësi të Bashkisë Mat dhe Njësive Administrative që përmbledh kjo bashki nuk janë inventarizuar të gjitha, si dhe nuk janë marrë në dorëzim me procesverbale. Dokumentacioni dhe të dhënat përkatëse në lidhje me asetet e Bashkisë janë vënë në dispozicion me shkresa zyrtare nëpërmjet VKM-ve përkatëse, si më poshtë:

c) Me vendimit përkatës janë transferuar pranë Bashkisë Mat 2,848 prona si ndërtesa, pyje, kullota toka, terrene, infrastrukturë etj. Nga 2,848 prona në total, të certifikuar kemi 75 prona. Të ndara si më poshtë:

#### Njësia Administrative Burrel.

Me VKM-në Nr. 771 datë 14.11.2007 janë transferuar 419 Prona nga këto 57 janë të certifikuar. Me VKM- në Nr. 408 datë 15.06.2022 është transferuar 1 (një) pronë me Nr 2/26 dhe pasuria me numër 2/306.Me VKM-në 806 datë 12.12.2022 është transferuar prona 717 me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve” në zonën kadastrale 1326. Në pronësi janë 386 prona dhe 34 prona janë në përdorim. Duke qenë se Bashkia Mat po bën përditësimin e inventarin e pronave rezulton se ka 386 prona në pronësi ky numër nuk është i saktë pasi shumica e pronave janë privatizuar nga qytetarët ndër vite. Pasi kjo VKM është e vitit 2007 dhe nga kjo periudhe deri më sot ka pësuar ndryshim.

#### Njësia Administrative Koms.

Me VKM nr.698 datë 16.08.2013 janë transferuar 921 prona nga këto 7 janë të certifikuar. Në pronësi janë 877 prona dhe 44 prona janë në përdorim. Duke qenë se Bashkia Mat po bën përditësimin e inventarin e pronave rezulton se ka 877 prona në pronësi ky numër nuk është i saktë pasi shumica e pronave janë privatizuar nga qytetarët ndër vite. Pasi kjo VKM është e vitit 2013 dhe nga kjo periudhe deri më sot ka pësuar ndryshim.

#### Njësia Administrative Ulez.

Me VKM nr.726 datë 01.07.2019 janë transferuar 427 prona (në pronësi) nga këto 6 janë të certifikuara.

Njësia Administrative Rukaj

Me VKM nr.886 datë 11.06.2008 janë transferuar 45 prona (në pronësi) nga këto 5 janë të certifikuara.

Njësia Administrative Baz

Me VKM nr.903 datë 11.06.2008 janë transferuar 145 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.

Njësia Administrative Dërjan

Me VKM nr.799 datë 04.06.2008 janë transferuar 55 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.

Njësia Administartive Lis

Me VKM nr.4 datë 04.01.2008 janë transferuar 372 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.(Ku lista e pronave ka ardhur në bashkinë Mat me shkresen me nr.5071 Prot me datë 15.11.2023). Me Vkm-nr.376 datë 27.03.2008 janë transferuar 131 prona.

Njësia Administrative Macukull

Me VKM nr.724 datë 01.07.2009 janë transferuar 463 prona (në pronësi) nga këto 0 janë të certifikuara.

Me VKM nr.1108 datë 30.12.2015 për transferimin nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave të bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit të personelit dhe aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, të bordeve rajonale të kullimit. Janë transferuar 56 prona të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit. Me VKM nr.433 datë 08.06.2016 për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike Bashkia Mat ka në pronësi 1752 prona, të cilat Administrohen nga Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë.

**Tabela nr.1** Transferimet me VKM të pronave.

Nr.	Nj.A	VKM		Në pronësi Në numër	Në përdorim Në numër	Çertifikuar	Inventarizuar	Vlerësuar	Kontabilizuar
		Numër	Datë						
1	Bashkia Mat	771	14.11.2007	386	34	57	273	273	273
2		408	15.06.2022						
3		806	12.12.2022						
4	NJA Komsj	698	16.08.2013	877	44	7			
5	NJA Ulëz	726	01.07.2019	427	-	6			
6	NJA Rukaj	886	11.06.2008	45	-	5			
7	NJA Baz	903	11.06.2008	145	-	-			
8	NJA Dërjan	799	04.06.2008	55	-	-			
9	NJA Lis	4	04.01.2008	372	-	-			
10	NJA Macukull	724	01.07.2009	463	-	-			
<b>Total</b>				<b>2,770</b>	<b>78</b>	<b>75</b>	<b>273</b>	<b>273</b>	<b>273</b>

**Burimi:** Bashkia Mat

Inventarët e pronave të paluajtshme të miratuara me VKM përgjatë viteve, dhe VKM për njësitë e tjera administrative nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Mat nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Mat, mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm që kanë pësuar këto pasuri, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

Në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30 konstatohet se nga strukturat përgjegjëse nuk janë ngritur grupet e punës apo ndërmarrë masa konkrete për ndjekjen e procedurës së inventarit të pasurive të paluajtshme sipas VKM respektive.

Konstatohet se, edhe në vitin 2023 nuk është marrë ndonjë masë apo procedurë ose ngritur një grup pune që do të ndjekë zbatimin e këtyre VKM si edhe regjistrimin e pronave në ASHK.

**Si konkluzion:** Me VKM-të përkatëse janë transferuar në total 2,848 pasuri si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat 75 pasuri të certifikuara dhe 78 pasuri në përdorim.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Mat nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2. germa a, b, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

#### **Bazuar VKM-në 433, datë 08.06.2016**

“Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje dhe kullota publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave e Bashkive”, këto janë sipërfaqet pyjore dhe kullosore në pronësi të Bashkisë Mat:

-Sipërfaqe totale: **35,160 ha**

\*E ndarë sipas formës së qeverisjes nga këto:

-Trungishte = **10,055.67 ha**

-Cungishte = **14,874.71 ha**

-Shkurre = **2,748.83 ha**

-Kullota = **2,999.03 ha**

-Bimësi pyjor = **1,333.58 ha**

-Djerr = **254.1 ha**

-Inproduktive = **28,88.88 ha**

-Ujore = **5.1ha**

Në territorin e Bashkisë Mat ndodhen Parku natyror Ulëz, Shkopet dhe Parku kombëtar Lurë-Mali i Dejës me sipërfaqe prej **5,448.26 ha**.

Bashkia Mat administron një sipërfaqe të fondit pyjor e kullosor prej **29,711.74 ha**, të ndara:

-Pyje = **23,540.94 ha**

-Bimësi pyjore = **1,085.13 ha**

-Djerrë = **61.36 ha**

-Inproduktive = **2,419.52 ha**

-Kullota = **2,602.52 ha**

-Ujore = **2.7 ha**.

Në **aneksin 2/4/1** bashkëlidhur raportit përfundimtar të auditimit paraqitet tabela me listën e pronave të regjistruara sipas objekteve dhe certifikatës së pronësisë.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi:**

1.Z. N.S, me detyrë Drejtor i Pronave dhe Mbrojtjes Civile

2.Z.R.N me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mbrojtjes Civile dhe Pronave

## **IV. REKOMANDIME**

### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve të pastrimit të qytetit nga mbetjet urbane për vitin 2023 në Bashkinë Mat, rezultoi se pastrimi i qytetit nga mbeturinat urbane kryhet dhe mbulohet nga vetë Bashkia Mat. Mbikëqyrja e pastrimit nuk ka qenë periodike dhe paraqet mungesë dokumentacioni, për efekt të justifikimit të punës së kryer, konkretisht:

- Akt-rakordimet mujore për mjetet e pastrimit lidhur me justifikimin e naftës të harxhuar janë të parregullta në formë dhe përmbajtje, pasi: janë mjaftuar vetëm me sasinë e karburantit të furnizuar, shpenzuar dhe gjendjen në fund, duke u firmosur vetëm nga përgjegjësja, përkatësisht:

Akt-rakordimet nuk kanë çelje në fillim dhe në fund, nuk kanë datë dhe numër si dhe nuk janë nënshkruar nga pala tjetër e drejtuesve të mjeteve dhe magazinieri.

Akt-rakordimet nuk pasqyrojnë shumën e kilometrave mujore të përshkuara nga çdo automjet sipas normativës së miratuar, për efekt të justifikimit të karburantit të harxhuar.

Njëkohësisht nuk janë krahasuar kilometrat sipas fletë-udhëtimeve me kilometrat sipas panelit të kontrollit ose akt-kolaudit (kontrolli teknik) të automjeteve, për efekt të saktësisë së kilometrave të pasqyruara në fletë-udhëtimet përkatëse.

Nuk disponohet asnjë informacion lidhur me mirëmbajtjen e varrezave e cila mbulohet nga Bashkia Mat.

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 61 të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Mat miratuar me Vendim të Këshillin Bashkiak në vitin 2016, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë publik” pika 36 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1,faqe 13-30 të Raportit të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Bashkia Mat dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat:

- Për mbajtjen e dokumentacionit të munguar të pastrimit, mbajtjen e akt rakordimeve të mjetit teknologjik dhe mjeteve të tjera të pastrimit duke krahasuar kilometrat e përshkuara sipas fletë-udhëtimeve me kilometrat sipas panelit të kontrollit të mjetit.

- Të sigurohet mbikëqyrje dhe informacion mujor periodik, për mirëmbajtjen e varrezave.

- Të marrë masa për mbulimin e shpenzimeve të pastrimit nga tarifa e pastrimit, e cila destinohet për këtë shërbim

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve për automjetet për vitin 2023 në Bashkinë Mat, rezultoi se dokumentacioni i karburantit të automjeteve, paraqet disa mangësi, konkretisht: Fletë-udhëtimet paraqesin disa parregullsi në plotësimin e tyre, pasi kanë korrigjime, plotësohen kilometrat pa u bazuar në kilometrazhin e miratuar në DPSHTRR për distancat midis rretheve dhe në vendimin e Këshillit të Qarkut për distancat e rrugëve brendshme të rrethit Mat.

Nuk janë rakorduar kilometrat e përshkuara sipas fletë-udhëtimeve me kilometrat sipas panelit të kontrollit ose akt-kolaudit (kontrolli teknik) të çdo automjeti.

Mungojnë normat mujore të miratuara në KB për çdo automjet, për vitin 2023.

Shpenzimet për funksionimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve gjatë vitit 2023 janë në vlerën 22,518,767 lekë, ose në masën 22 % ndaj shpenzimeve operative.

Automjete të cilat nuk janë në gjendje pune janë 3 ,për këto automjete nuk janë mbajtur procesverbalet për vlerësimin e gjendjes së tyre tekniko-xhenerike–motorike me komision në përbërje me specialiste të fushës (*ing. mekanik*), mungon relacioni dhe analiza në KB, për fillimin e procedurave ligjore për asgjësimin ose kalimin në ankand të tyre.

Veprime në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik” kap IV, pika 73-80 .(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-30 të Raportit të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Mat dhe Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat:

-Për plotësimin e fletë-udhëtimeve me gjithë të dhënat që kërkohen në bazë distancave të miratuara nga DPSHTRR dhe nga KQ për distancat e rrugëve jashtme dhe të brendshme.

-Për hartimin dhe miratimin në Këshillin Bashkiak të normave mujore të karburantit për çdo makinë.

-Për vlerësimin e gjendjes teknike-xhenerike të automjeteve nëse janë rentabël ose jo, pasi janë të amortizuara sidomos mjetet e ardhura nga ish-komunat sot njësite administrative.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se totali se detyrime të prapambetura në datën 01.01.2023 janë në vlerën 20,575,921 lekë.Gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa në shumën 279,145,754 lekë dhe pakësime në vlerën 270,648,345 lekë.Totali progresiv në datën 31.12.2023 është në

vlerën 29,073,330 lekë. Bashkia Mat nuk ka prioritarizuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura por ka marrë angazhime të reja buxhetore pa pasur fonde e cila ka sjell rritjen e detyrimeve me vlerën 8,497,409 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF 5 datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, me Udhëzimin plotësues “Për buxhetin vitit”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura në Njësitë Vetëqeverisjes Vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-30 të Raportit të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, pasi mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat/tarifat vendore, rezulton se:

- Drejtoria Ekonomike dhe e të Ardhurave/Sektori i Taksave e Tarifave Vendore në Bashkinë Mat, informacionin tatimor e përpunon në programin Excel. Mungesa e një sistemi IT bashkëkohor për të ardhurat vendore, sjell vështirësi në administrimin e informacionit tatimor nga ana e DEA/STTV.

- Bashkia Mat deri në datën 31.12.2023 nuk ka bërë rakordimet me ASHK për taksën e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme, ndërsa me DRSHTRR për mjetet e regjistruara nuk janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE;

- Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e brendshme të institucionit, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë, mbajtjen e akt-rakordimeve me ta dhe krijimin e një baze të dhënash me të dhënat përkatëse nga agjentët;

- Nga analiza e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2023, rezultoi si më poshtë: për vitin 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë realizuar në vlerën 106,983 mijë lekë ose në masën 86.5%; për vitin 2023 janë realizuar në vlerën 113,353 mijë lekë ose në masën 88.7%. Pra nga viti 2022 në vitin 2023 ka patur një rritje të të ardhurave kundrejt planifikimit prej 2.2%. Për vitin 2023, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 127,752 mijë lekë ose 4,005 mijë lekë më shumë se viti 2022 dhe janë realizuar në vlerën 113,353 mijë lekë ose 6,370 mijë lekë më shumë;

Realizimi i të ardhurave të veta *për vitin 2023* është në masën 88.7% ose 14,399 mijë lekë më pak kundrejt planifikimit të tyre. Referuar vlerës 14,399 mijë lekë të mosrealizimit, disa prej zërave fiskalë të cilët nuk janë realizuar në krahasim me planin vjetor të të ardhurave të veta si më poshtë: TNI për vitin 2023 është parashikuar në vlerën 8,739 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 3,397 mijë lekë ose 38.9% e vlerës së planifikimit, me 3,417 mijë lekë më pak se në vitin 2022;

Taksa e rentës minerare, është parashikuar në vlerën 530 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 122 mijë lekë ose në masën 23%, krahasuar me vitin 2022 rezulton me 117 mijë lekë më shumë;

Qira nga ndërtesat është parashikuar 2,092 mijë lekë dhe janë arkëtuar 568 mijë lekë ose në masën 27.2%, por krahasuar me vitin 2022 ka ardhur në rritje në shumën 294 mijë lekë; etj

Referuar të dhënave të sipërpërmendura me tejkallim paraqiten zërat fiskalë si më poshtë:

Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 11,438 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 13,300 mijë lekë ose në masën 116.3% të tij, por vlera e saj ka ardhur në rënie prej 157.3 mijë lekë më pak se në vitin 2022;

Taksë e mjeteve në qarkullim është parashikuar në vlerën 11,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 12,703 mijë lekë ose në masën 115.5% , krahasuar me vitin 2022 është 246 mijë më pak;

Mos realizimi i të ardhurave ka ardhur si rezultat i mungesës së analizave periodike dhe vjetore mbi mosrealizimin e tyre dhe mungesës së bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes strukturave përgjegjëse që sigurojnë të ardhura duke mos u administruar në kohë informacioni tatimor nga ana e STTV.

- Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 kanë aplikuar dhe kanë pezulluar aktivitetin në QKB 39 subjekte, prej të cilave 24 subjekte janë pezulluar pa marrë paraprakisht vërtetimin mbi detyrimet ndaj Bashkisë Mat; nga këto 24 subjekte 3 prej tyre e kanë paguar detyrimin menjëherë sapo janë njoftuar. Vlera totale e detyrimit të 21 subjekteve të pezulluara deri në 31.12.2023 është në vlerën 3,477,088 lekë. Kjo mungesë bashkëpunimi mes QKB dhe Bashkisë Mat ka sjellë vështirësi në arkëtimin e vlerës debitoare. Nga auditimi rezulton se numri i aktiviteteve të pezulluara ka ardhur në rritje nga viti 2022 në vitin 2023 me 5 subjekte dhe se nga STTV nuk ka një analizë mbi shkaqet që kanë çuar në rritjen e numrit nga viti në vit të subjekteve private që kanë mbyllur/pezulluar aktivitetin.

-Për debitorët e biznesit, konstatohet se nuk është aplikuar kamatëvonesë rast pas rasti, për mos likuidim të detyrimit tatimor, në kundërshtim me Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 6 pika3, neni 69 pika 2/d, neni 76; ligjin nr. 139/2015 “për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar.

- Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore për vitin 2023, janë marrë disa masa si “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokim i llogarive bankare” apo pasurive të luajtshme e të paluajtshme si rezultat i të cilave është mundur të mblidhet pjesërisht borxhi në vlerën 11,085,638 lekë. Nga auditimi rezultoi se nga STTV nuk është vijuar për marrjen e masave të tjera shtrënguese, mosveprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI;

- Në paketën fiskale të vitit 2020, me VKB u miratua si opsion lidhja e marrëveshjes me debitorët për shlyerjen e detyrimit me këste nga ana e tyre. Kjo marrëveshje do të lidhej nga Agjenti Tatimor UK Mat me subjektet/abonentë debitoare. Rezulton se janë lidhur akt marrëveshje, por dokumentet nuk i janë vënë në dispozicion Zyrës Juridike dhe DEA /STTV. Kjo ka sjellë që nga STTV të mos ketë informacion mbi respektimin e kushteve të marrëveshjes nga ana e debitorëve lidhur me pagesën e kështit në afat si dhe përfundimin në afat ose jo të marrëveshjes, por nga akt rakordimet e vëna në dispozicion pasqyrohen vetëm arkëtimet e kryera dhe vlera e detyrimit të mbetur në fund të çdo viti ushtrimor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-45 të Raportit të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat, të marrë masat për implementimin e programeve kompjuterike si pjesë e rëndësishme infrastrukture, për mirë administrimin e informacionit tatimor, për të maksimizuar arkëtimin e taksave dhe rritjen e bashkëpunimit mes strukturave të përfshira në arkëtimin e takasave/tarifave vendore; kjo duke krijuar një regjistër elektronik që të përmbajë gjithë të dhënat e tatimpaguesve, me të gjitha detyrimet të klasifikuara sipas kategorisë së detyrimit, kohës së krijimit, interesat, gjobat dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit, për një menaxhim në kohë reale të informacionit;

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat, GMS dhe Sektori i Taksa e Tarifave Vendore të marrin masa për:

- Një planifikim sa më realist të të ardhurave, duke u mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin real të taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave. Kjo shmang edhe marrjen e angazhimeve buxhetore mbi bazën e planifikimit të të ardhurave dhe jo atij faktik.

- Të caktojë në STTV një person përgjegjës për të lidhur marrëveshjet me ato institucione të cilat do të jenë në rolin e agjentit tatimor, për të kryer rakordim periodik mujor me agjentët tatimorë sipas formularit përkatës të miratuar nga Ministria e Financave, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Mat nga taksat që mblidhen nga këta agjentë. Në rast se agjentët tatimorë nuk realizojnë dhe pasqyrojnë saktë mbledhjen e të ardhurave, Bashkia Mat të fillojë procedurat për penalizimin e tyre sipas kuadrit ligjor në fuqi.;

- Për çdo debitor biznesi të llogaritet kamatvonesa dhe ti përcillet debia si vlerë totale në fletënjoftimet e secilit debitor;
- Të ndjekë të gjithë hapat ligjorë, për të arkëtuar në masë të plotë debinë e krijuar si dhe për të parandaluar krijimin e debive të reja për periudhën në vijim;
- T'i kërkojnë UK-sha gjithë marrëveshjet e lidhura me subjektet debitore për pagesën me këste të detyrimit, me qëllim ndjekjen e arkëtimeve nga pagesa e kësteve dhe respektimit të kushteve të marrëveshjes nga ana e debitorëve, për rritjen efektive në arkëtimin e të ardhurave nga taksa e tarifafat vendore;
- Të analizojë shkaqet e rritjes nga viti në vit të numrit të subjekteve që kanë mbyllur apo pezulluar aktivitetin, që ka sjellë ulje në vlerë të burimit të të ardhurave të bashkisë, nga taksat e tarifafat vendore;

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.3. Rekomandimi:** Sektori i infrastrukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Bashkiake të marrin masa për pajisjen me leje të subjekteve që tregtojnë hidrokarbure me afatin e përcaktuar në kuadrin ligjor për këtë lloj aktiviteti; të analizojë situatën e krijuar me 2 subjektet e bllokuara, me qëllim që në periudhat e ardhshme të arkëtohen detyrimet brenda afatit ligjor, arkëtimin e atyre të prapambetura për të parandaluar krijimin e detyrimeve të reja.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Për vitin 2023 Bashkia Mat nuk ka hartuar pasqyrat e konsoliduara. Bashkia Mat ka 3(tre) ndërmarrje varësie ,Ndërmarrja e Shërbimeve, Klubi i Futbollit Burrel dhe Tregu Mat.

Bashkia Mat ka hartuar pasqyrat individuale të aparatit të bashkisë të cilat i ka dorëzuar në degën e Thesarit Mat me shkresën nr 1275 prot, datë 28.03.2023.

Ndërmarrja e Shërbimeve Bashkia Mat ka depozituar në degën e thesarit Mat pasqyrat financiare në datë 13.03.2023 të cilat janë miratuar nga dega e thesarit në datë 29.03.2023.

Klubi i Futbollit Burrel ka depozituar në degën e thesarit Mat pasqyrat financiare në datë 29.03.2023 të cilat janë miratuar nga dega e thesarit në datë 29.03.2023.

Tregu Mat ka depozituar në degën e thesarit Mat pasqyrat financiare në datë 22.04.2023.

Bashkia Mat ka vepruar në kundërshtim me udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, kapitulli IV, pika 98 *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 49-59 të Projekt Raportit të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike, Bashkia Mat të hartojë pasqyrat financiare të konsoliduara për të pasqyruar informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Llogaria 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” sipas udhëzimit të MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kreditohet nga investimet, dhurimet dhe pakësohet nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet jashtë përdorimit.

Llogaria 101 “Teprica” është regjistruar në datë 01.01.2023 për vlerën 3,257,823,616 lekë, gjatë vitit 2023 ka pasur shtesa në vlerën 277,299,031 lekë nga investimet dhe dhurimet, pakësimet kanë qënë në vlerën 158,774,886 lekë nga amortizimi i vitit dhe nxjerrjet nga përdorimi. Shtesa neto e llogarisë 101 “Teprica” për vitin 2023 është në vlerën 118,524,145lekë. Në datë 31.12.2023 kjo llogari është pasqyruar për vlerën 3,941,033,038 lekë.

Sipas analizës së mësipërme llogaria 101 është raportuar në bilanc e mbivlerësuar për vlerën 550,100,013 lekë në kundërshtim me udhëzimin e MFE Nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e

përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 101 “Teprica (Fond i akumuluar)/Deficit i akumuluar” për të dhënë informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Mat më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 128,552,350 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Për objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Mat janë ngurtësuar fonde në vlerën 9,151,351 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Mat, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimi të Territorit dhe Drejtoria Ekonomike nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 9,151,351 lekë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Veprime në kundërshtim me udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të marrë masa për të njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për garancitë të cilat tashmë u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratën e investimit përkatës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe Konstrukione” gjatë vitit 2023 janë transferuar 2 (dy aktive) në njësitë e varësisë. Ndërtesa “Agjencia e Rrugëve” e kontabilizuar në llogarinë 212 në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë Mat me kosto historike 174,036 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 66,298 lekë dhe vlerë neto në shumën 107,738 i ka kaluar në përdorim, Ndërmarrjes së Shërbimeve.

Tregu Mat i kontabilizuar në llogarinë 212 në pasqyrën e pozicionit financiar të Bashkisë Mat me kosto historike 88,139,387 lekë, amortizim i akumuluar në vlerën 34,266,120 lekë dhe vlerë neto në shumën 53,873,267 i ka kaluar në përdorim, “Tregu Mat” Sh.a. Referuar pasqyrës së pozicionit financiar aktiv i “Tregu Mat” është transferuar me vlerë kontabël në shumën 67,357,533 lekë, amortizim të akumuluar 24,019,225 lekë dhe vlerë neto në shumën 43,338,308 lekë. Vlera e transferuar e aktivitetit nuk është vlera e drejtë e tij.

Për aktivin “Tregu Agro-Ushqimorë” në bazë të shkresës nr. 1693 prot, datë 19.04.2022 është kryer vlerësimi i pasurisë nr. 948/ND lloji i pasurisë ndërtesë. Në bazë të vlerësimit nga vlerësuesi i pavarur ky aktiv është vlerësuar për vlerën 30,211,950 lekë. Në fund të vitit 2022 dhe në fund të vitit 2023 ky aktiv është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar i pa rivlerësuar në kundërshtim me udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike, Bashkia Mat të kryejë kontabilizimet në klasat e aktivitetit në përputhje me legjislacionin për të pasur informacion kontabël të saktë dhe të besueshëm.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**9. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 2,003,790,449 lekë. Llogaria llogarive 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” dhe 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” përbëhet nga 16 investime në proces të cilat i përkasin viteve 2020-2023. Gjatë vitit 2023 kemi pasur shtesa në llogari shumën 599,317,254 lekë dhe pakësim për 4 projekte investimi në shumën 80,915,191 lekë të cilat janë kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”.

Shuma e pakësimeve nuk pasqyron gjendjen reale të aktivitetit sepse shtesat e aktivitetit afatgjatë material gjatë vitit 2023 llogaria 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” për aktivitet “Shkolla 28 Nëntori” është debituar për vlerën 99,997,515 lekë, “Shkolla Mustafa Gjestila” në vlerën 106,420,725 lekë dhe “Aneksi i Stadiumit” në vlerën 41,099,223 lekë. Kontabilizimet në llogarinë 231 “Investime” janë kryer në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 “Për përgatitjen, paraqitjen e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, pagesat pjesore për krijimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Investime në proces” dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**10. Gjetje nga auditimi:** Në gjendjen e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” janë përfshirë pesë aktive me emërtimin “Rregullim Lulishte Shkolla Shilli” me kosto historike 152,000 lekë, “Shkolla 9-vjeçare Mustafa Gjestila” me kosto historike 1,024,598 lekë, “Shkolla 9-vjeçare, 31-Korriku” me kosto historike 1,024,599 lekë, “Sporti” me kosto historike 17,258,985 lekë dhe “Këndi i lojërave” me kosto historike 3,482,161 lekë. Regjistrimet e mësipërme kanë mbivlerësuar llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” për vlerën 22,942,342 lekë dhe kanë nënvlerësuar llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në vlerën 22,942,342 lekë Referuar Standardit Kombëtar të Kontabilitetit “Aktivitet afatgjata materiale dhe aktivitet afatgjata jo materiale” i përmirësuar, pikat 2, 10 dhe 21, dhe Udhëzimit nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësitë të Qeverisjes së Përgjithshme”, aktivitet duhej të klasifikoheshin në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione”. (Trajtuar më hollësisht në pikën 2.3 faqet 46-59 të Raportit të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e vlerës 22,942,342 lekë me kosto historike për aktivitet, “Rregullim Lulishte Shkolla Shilli”, “Shkolla 9-vjeçare "Mustafa.Gjestila”, “Shkolla 9-vjeçare,"31-Korriku”, “Sporti” dhe “Këndi i lojërave” së bashku me vlerën e amortizimit të përlllogaritur, duke e pakësuar si aktiv nga llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe duke e kontabilizuar në llogarinë 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione” në zbatim të dispozitave ligjore përkatëse.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, paraqitet në vlerën 28,625,929 lekë në datë 31.12.2023. Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerën 10,550,203 lekë në datë 31.12.2023. Në llogaritë e mësipërme nuk janë kontabilizuar vlera e tokave, trojeve dhe terreneve që me VKM janë transferuar Bashkisë Mat dhe ish Komunave sot Njësitë Administrative. Veprimet dhe mosveprimet bien në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75 dhe Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 5, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe

konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30.(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Projekt Raportit të Auditimit*).

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogarit . 210 “*Toka, Troje, Terrene*” dhe 211 “*Pyje, Plantacione*” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

*Me mbylljen e PF të vitit 2024*

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjatë periudhës 2007-2022 sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “*Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*” nëpërmjet VKM në Bashkinë Mat janë transferuar 2,848 pasuri. Në NjA Burrel me VKM nr.771,datë 14.11.2007 janë transferuar 419 pasuri, me VKM nr. 408, datë 15.06.2022 është transferuar 1 (një) pasuri me nr. 2/26 dhe pasuria me nr.2/306, me VKM nr. 806, datë 12.12.2022 është transferuar pasuria me nr. 717 me emërtim “*Shtëpia e Ushtarakëve*” në zonën kadastrale 1326. Në NjA Komsi me VKM nr.698, datë 16.08.2013 janë transferuar 921 pasuri. Në NjA Ulëz me VKM nr.726, datë 01.07.2009 janë transferuar 427 pasuri. Në NjA Rukaj me VKM nr.886 datë, 11.06.2008 janë transferuar 45 pasuri. Në NjA Baz me VKM nr.903, datë 11.06.2008 janë transferuar 145 pasuri. Në NjA Dërjan me VKM nr.799, datë 04.06.2008 janë transferuar 55 pasuri. Në NjA Lis me VKM nr.4 datë 04.01.2008 janë transferuar 372 pasuri, me VKM-nr.376 datë 27.03.2008 janë transferuar 131 pasuri. Në NjA Macukull me VKM nr.724, datë 01.07.2009 janë transferuar 463 pasuri. Nga pasuritë e transferuara 75 pasuri janë pajisur me çertifikatë pronësie, 78 pasuri janë të pajisura me çertifikatë përdorimi dhe 2,767 pasuri nuk janë pajisur me çertifikatë pronësie.

Inventarët e pasurive të paluajtshme të miratuara nuk përbëjnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Mat nuk është rakorduar me Zyrën Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si pasojë, inventari rezultoi i papërditësuar. Veprime këto në kundërshtim me neni 37 i ligjit nr. 20/2020 “*Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 59-62 të Raportit të Auditimit)*).

**12.1.Rekomandimi:** Bashkia Mat të marrë masa për të krijuar një sektor të posaçëm për kadastrën, si pjesë të strukturës organike, me qëllim realizimin e detyrave për hartimin dhe përditësimin e inventarëve të pasurive të paluajtshme të bashkisë, përfshirë ish-komunat, aktualisht njësi administrative. Të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogarisë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie

*Brenda datës 31.12.2024*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” paraqiten në datën 31.12.2023 në vlerën 71,947,410 lekë.Vlera prej 71,947,410 lekë përbëhet nga 62,384,066 lekë detyrim për taksa dhe tarifa vendore biznes dhe vlera prej 9,596,344 lekë nga gjobat e vendosura nga IMTV përgjatë viteve në shumën 2,750,000 lekë dhe vlera prej 7,596,344 lekë i përket debitorëve familjarë të trashëguar nga ish-komunat përpara vitit 2015. Sipas shkresës me nr.1105 prot, Drejtoria Juridike dhe Taksave Vendore ka dërguar në Drejtorinë Financës listën e debitorëve deri në datën 31.12.2023 në vlerën 40,994,360 lekë vetëm abonentët biznes pa përfshirë debitorët familjarë dhe gjobat e IMTV. Gjithashtu debitorët e biznesit kanë diferencë midis detyrimit që disponon Drejtoria e të Ardhurave me detyrimin e kontabilizuar nga Drejtoria e Financës për vlerën 21,356,706 lekë.Veprime këto në kundërshtim me neni 5 i ligjit nr. 9632,

datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar”.(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-59 të Raportit të Auditimit).

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me DTTV Bashkia Mat të marrin masa për rakordimin e debitorëve sipas dretorive dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet dhe regjisttrat e llogarive të DTTV

*Brenda datës 31.12.2024*

## **B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuar se detyrimet progresive për taksa dhe tarifata vendore për abonentë privatë në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 45,441,358 lekë dhe përbëhet nga 410 abonentë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 13,308,015 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 8,537,880 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën **40,671,223 lekë për 353 abonentë privatë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 34-50, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksa dhe Tarifa Vendore në bashkëpunim me drejtorinë e tjerë të Bashkisë Mat të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve në vlerën 40,671,223 lekë për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

### **B.1. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se detyrime progresive për taksat dhe tarifata vendore për abonentët familjarë në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 55,759,890 lekë e përbërë nga 15,005 abonentë. Pagesa për detyrimet e prapambetura gjatë vitit 2023 janë në vlerën 17,981,454 lekë. Shtesat gjatë vitit 2023 janë në vlerën 12,708,125 lekë dhe detyrimet progresive në datë 31.12.2023 janë në vlerën **50,486,470 lekë dhe përbëhet nga 11,822 abonentë familjarë**, te cilat janë të pa kontabilizuara. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-45, të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksa dhe Tarifa Vendore në bashkëpunim me drejtorinë e tjerë të Bashkisë Mat të marrin masat administrative e ligjore duke ndjekur të gjitha rrugët për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve në vlerën **50,486,470 lekë** për të bërë të mundur rritjen e performancës dhe uljen e borxhit që mund të krijohet nga mos ndjekja e tyre.

*Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2025*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se:

- Mbi aktivitetin e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure, në mbyllje të vitit 2023 rezultojnë 3 subjekte debitorë të pa kontabilizuara, nga të cilat për 2 subjekte debia është në vlerën totale 1,200,000 lekë, ndërsa për subjektin "M", Sektori i Infrastrukturës nuk ka informacion mbi detyrimin, pasi ky subjekt e ka ushtruar aktivitetin e tij prej disa vitesh i pa pajisur me licencë

përkatëse, si dhe nuk ka një analizë për të llogaritur vlerën e detyrimit apo të gjobës që duhet t'i ngarkohet. Masa e vetme është ajo e bllokimit të llogarive bankare.

-Në Bashkinë Mat kanë ushtruar aktivitetin e tyre 12 subjekte, nga të cilat 2 subjekteve iu janë bllokuar llogaritë bankare dhe nuk janë pajisur me licence për periudhën në vijim. Konstatohet se nga ana strukturave përgjegjëse të licencimit, pajisja me leje vetëm në 1 rast është dhënë leje me afat 5 vjeçar, në 10 raste variojnë me afat nga 1 deri në 3 vjet.

Veprimet dhe mosveprime bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” neni 89, Ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre” i ndryshuar; Kreu II në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-45 të Raportit të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Shërbimeve Bashkiake dhe Sektori i Infrastrukturës në bashkëpunim me STTV dhe Sektorin Juridik të analizojnë situatën specifike të subjektit “M” dhe marrin masa për të llogaritur saktë detyrimin ndaj tij për ushtrim të aktivitetit në kundërshtim me kuadrin ligjor si dhe kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës 1,200,000 lekë të 2 subjekteve debitore, për rritjen e të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Mat.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se detyrime progresive për gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake në datën 01.01.2023 paraqiten në vlerën 1,693 mijë lekë. Gjaë vitit 2023 kemi rritje të shumës debitore me vlerën 739 mijë lekë. Debia progresive në datën 31.12.2023 është në vlerën 2,201 mijë lekë dhe i përket 2,927 debitorëve, e cila është e pa kontabilizuar. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2,2 faqe 30-45 të Raportit të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksa e Tarifave Vendore, Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Policinë Bashkiake të marrin masa për të mundësuar kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës progresive 2,201,000 lekë për 2,927 debitorë si dhe për parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj, për të bërë të mundur arkëtimin nga kundërvajtësit brenda afateve ligjore vlerën e gjobave të vendosura.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi kontratat e qirave, rezulton se: Nga Bashkia Mat janë lidhur gjithsej 13 kontrata qiraje, nga të cilat 3 kontrata janë të vitit 2023. Vlera detyrimeve të këtyre kontratave deri më 31.12.2022 paraqitet në shumën 9,009,204 lekë për 11 subjekte dhe deri në fund të vitit 2023 kjo vlerë është prej 9,555,857 lekë për 13 subjekte, duke u shtuar për vlerën 546,653 lekë. Vlera e kontratave të palikujduara është e pakontabilizuara në pasqyrat financiare 2023. Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, dhe VKM nr. 54, datë 05.02.2014, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 30-45 të Raportit të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Bujqësisë dhe Pyjeve në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Drejtorinë Ekonomike të marrin masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimit ndaj 13 subjekteve në vlerën progresive të debisë 9,555,857 lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në datën 01.01.2023, Bashkia Mat ka pasur 3 vendime gjyqësore me vlerë 3,803,429 lekë ndaj ish-punonjësve. Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 6 vendime gjyqësore me vlerë detyrimi 37,235,386 lekë. Bashkia Mat gjatë vitit 2023 ka shpenzuar vlerën 30,242,573 lekë për 5 vendime gjyqësore, ku nga këto vlera prej 21,241,152 lekë janë shpenzime gjyqësore për personat me aftësi të kufizuar të cilat mbulohen nga fondet e Ministrisë së Shëndetësisë. Vlera 30,242,573 lekë e shpenzuar për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga Bashkia Mat, për likuidimin e vendimeve gjyqësore, konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet.

Vendimet gjyqësore nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësive administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative për to, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësia vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore, evidentimin e procedurave të bëra gabim, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Veprime këto në kundërshtim me UMF nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, pika 60. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-30 të Raportit të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mat të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatojë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kane sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen e çështjeve gjyqësore, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **D. MASA DISIPLINORE**

### ***E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:***

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mat, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

#### **a) Pëzullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.**

**1. Z.E.R** me detyrë Drejtori i Shërbimeve Bashkia Mat.

- Për mos vlerësimin e 38 automjeteve të bashkisë nëse janë rentabël ose jo, për efekt të reduktimit numrit të larte të tyre, për pasoje edhe uljes së shpenzimeve të automjeteve. Për veprime/mosveprime në kundërshtim me UMF 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve njësitë publik”,

- Për lejimin e aktrakordimeve të mjeteve bashkisë të parregullta, pasi nuk janë rakorduar kilometrat e përshtuara sipas fletudhëtimeve me kilometrat sipas panelit të kontrollit (*ose aktkolaudimit, kontrollit teknik*) të çdo makine, për efekt të saktësisë të kilometrave të pasqyruara në fletudhëtimet përkatëse për justifikimin e karburantit.

**2. Znj. M.L** me detyrë Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve.

- Për mungesë të mbikëqyrjes së pastrimit në mënyre periodike.

- Për mos disponimin e asnjë informacioni lidhur me mirëmbajtjen e varrezave.

- Për veprime në kundërshtim me nenin 57 të rregullores brendshme të Bashkisë Mat

**3. Znj. L.K** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Pastrimit Mbetjeve Urbane Bashkia Mat.

*Për shkeljet e mëposhtme:*

- Për mungese të mbikëqyrjes së pastrimit në mënyre periodike.
- Për mungese të dokumentacionit që shpreh punën e kryer nga punëtorët e normuar të pastrimit, lidhur me volumin e punës sipas normativave ligjore, për efekt të ngarkesës dhe shfrytëzimit të kohës punës, por është mjaftuar vetëm me listë prezencën e tyre
- Për mbajtjen e pjesshme dhe të parregullt të aktrakordimeve për mjetin e pastrimit AB603GB, lidhur me naftën e furnizuar, të harxhuar dhe gjendja në fund muajit, pasi akt-rakordimet ishin të parregullta në formë dhe në përmbajtje, pasi nuk janë plotësuar me gjithë të dhënat e kërkuara si dhe nuk ka nënshkrime nga pala tjetër e drejtuesve të mjeteve dhe magazinieri. Nuk ka rakordim midis kilometrave sipas fletëudhëtimeve dhe kilometrave sipas panelit të kontrollit (*akt-kolaudit, kontrolli teknik*) të automjeteve, për efekt të saktësisë së kilometrave të pasqyruara në fletëudhëtimet përkatëse, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*, pika 36,
- Për mungese dokumentacioni për të pasqyruar dhe zbritur sipërfaqet e zëna nga rikonstruksionet e rrugëve, shesheve, trotuareve të qytetit të kryera gjatë vitit 2023, objekt investimesh.
- Për mos disponimin e asnjë informacioni lidhur me mirëmbajtjen e varrezave.
- Për veprime në kundërshtim me nenin 61 të rregullores brendshme të bashkisë Mat.

## **E. NJOFTIM PËR DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIN PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit për të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Mat, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **GRUPI I AUDITIMIT**

- 1. K.H**
- 2. B.B**
- 3. S.J**
- 4. K.F**

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**

**J.T**